



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.9(435)

SHTATOR 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

IN MEMORIAM

PESË VJET PA GJENERAL PARLLAKUN - "NDERI I KOMBIT"



Kolonel Trifon LLUPO
Nënkrjetar i OBVL

FAQE 5

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU



NEVOJA E NJË LIDERSHIPI TË MIRË NË KUSHTET E SOTME

Nga Sakip Cami

FAQE 6

REPORTAZH

DIASPORA, FESTË NË FSHATIN E MARTIRIZUAR



Halil RAMA – Mjeshtëri i Madh

FAQE 8

80 vjetori i Çlirimit/ Rreshtimi i Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan

RRUGA E LAVDISHME E BRIGADAVE TË 20-të, 22-të DHE 23 –të TË USHTRISË NCÇL

Konferenca e Pezës në çështjen kombëtare

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Konferenca e Pezës e mbajtur më 16 shtator 1942 është ngjarja më madhore e LANÇ-it, për të cilën është shkruar e do të shkruhet në shekuj. Vlera e kësaj konference qëndron në rëndësinë e vendimeve për fatet e kësaj lufte. Detyra jonë është që kjo të nderohet e të përkujtohet. Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike. Këto pavarësisht nga bindjet, alternativat e orientimet e ideologjike, gjithmonë i bashkon një çështje e madhe e përbashkët, çështja kombëtare, përparimi dhe bashkimi i kombit. Konferenca e Pezës gjithmonë përbën një objekt me rëndësi studimi e hulumtimi për historinë. Në vitet e demokracisë ku mendimi i lirë pluralist, ka përparësi, opinioni publik ka lexuar shkrime me vlerësime të ndryshme për Konferencën e Pezës dhe protagonistët e saj. Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e iniciuan, t'u bëhet vlerësimi i duhur. Rëndësia e Konferencës së Pezës qëndron në rolin që luajti në ecurinë e procesit të luftës. Vendimi për thirrjen e Konferencës, kur situata ishte e rëndë, e vështirë, e mbushur me rreziqe të mëdha, për ekzistencën si popull e si komb.

VIJON NE FAQEN 2



Vlerat antifashiste nuk vjetërohen kurrë. Ato qëndrojnë në themel të lirisë, të përparimit, të kontributit tonë në NATO, për paqen, sigurinë e stabilitetin në rajon e në botë, në themel të rrugëtimit europian të Shqipërisë

FAQE 12 - 13

KUJTIME

PAS PEZËS, "KUVENDI" NDËRKRAHINOR NË VINÇAN

Nga gjeneral Nexhip VINÇANI

FAQE 4

PROMOVIMI



Promovohet romani "Shtëpia e verdhë", vepra më e re e shkrimtarit dhe dramaturgut të njohur Bashkim Hoxha

FAQE 16

OPINION

HILEJA E NDËRKOMBËTARËVE PËR URËN E IBRIT

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 10

REFLEKSIONE

NGËRÇI NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Nga Bashkim Hisari

FAQE 11

LIBRI STUDIMOR I XHEMAL MEÇIT

"NA KA ÇUE SHKODRA NI FJALË"

FAQE 14 - 15

100 VJETORI I LINDJES

FLUTURAK ASABELLA (VINÇANI) ISHTE NJERI I IDEALEVE TË PASTRA

Nga Genc Ballanca

FAQE 5

LIBRI "LUFTËTARI I LIRISË"

ATDHËDASHURIA, LAJMOTIVI I HYSEN DERVISHIT

FAQE 10

PROFILI

FERIDE KURTI, VETERANIA E KËNGËS MATJANE

NGA MEVLUD BUCI

FAQE 8

ANALIZA

Konferenca e Pezës në çështjen kombëtare

Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

(vijon nga fq. 1)

Shoqëria shqiptare gjendej në udhëkryq, ndaj kërkohet reflektim i thellë, shpejt, mobilizim e angazhim i përgjithshëm, i forcave patriotike në vend, për të marrë në dorë fatet e atdheut që vuante nga pushtimi fashist. Shpëtimi dhe çlirimi i vendit do të vinte nga populli, që priste të organizohej e të mobilizohej për luftë. Konceptimi i situatës, ndjenja e përgjegjesisë, preokupimi për zgjidhjen e problemeve të popullit shqiptar, bënë që pas një pune përgatitore, të arrihej marrëveshja midis forcave dhe rrymave të ndryshme që ekzistonin në vend, në thirrjen e Konferencës së Parë Kombëtare Nacionalçlirimtare. Një mbledhje e tillë nuk ishte e lehtë, por preokupacioni e angazhimi i forcave pjesëmarrëse ishte në kohën dhe momentin historik që kalonte vendi. Në procesin e përgatitjes së mbledhjes u kapërcyen hezitimet, ngurrimet e dyshimet për njëri-tjetrin. U arrit që në tryezën e bisedimeve të ulen njerëz me bindje, me pririje e me orientime të ndryshme ideologjike, për hir të interesave kombëtare. Konferenca siguroi një përfaqësim të gjerë, duke i dhënë të drejtën legjitime për të vepruar me përgjegjësi të lartë përpara historisë, për fatet e popullit që ishte ngritur në luftë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

ORGANIZIMI I LUFTËS SË ARMATOSUR

Në shtypin e demokracisë shpesh është diskutuar se kush ishte iniciatori dhe organizator e Konferencës, ishte kjo fryt i preokupimit, i punës dhe i aktivizimit të disa njerëzve të veçantë, me autoritet, me njohje e lidhje të gjëra në rrethet nacionaliste; apo ishte produkt i një mendimi të përpunuar mirë nga një forcë politike e organizuar e serioze që kishte dhe vizion për gjendjen në vend e për rrugët e zgjidhjes. Dihet se e vetmja forcë politike e organizuar në vend në atë kohë ishte Partia Komuniste. Ajo mori përsipër dhe i takon dhe merita e organizimit të Konferencës dhe dokumenteve të saj. Në atë kohë Partia Komuniste kishte shpallur hapur qëndrimin ndaj pushtuesit dhe marrë masat e para në organizimin e luftës së armatosur. Për organizimin e luftës kundër pushtuesit nuk ishin të interesuar vetëm komunistët. Shqetësim dhe gatishmëri kishin patriotët dhe atdhetarë të ndershmë, të



orientimeve dhe besimeve të ndryshme nga mbarë vendi. Kjo përputhje interesash jetike, ky preokupim i përbashkët i forcave atdhetare, krijoi premisat e duhura për kontakt e dialog midis tyre, produkt i të cilave ishte edhe vendimi për thirrjen e Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare. Ka pasur dhe ka edhe sot mendime se Konferenca e Pezës ishte makinacion i Partisë Komuniste. Por Partia Komuniste nuk ishte si Partia Fashiste në shërbim të okupatorit. Kjo parti ishte dhe mbeti deri në fund për luftë të armatosur e vendosur për të luftuar nazifashizmin dhe çlirimin e vendit. Në Pezë kjo forcë kërkoi bashkimin e të gjitha forcave politike të vendit, komuniste e antikomuniste, zogiste e antizogiste, për të rifituar me luftën e armatosur pavarësinë e atdheut dhe për pjesëmarrje të Shqipërisë në koalicionin e madh antifashist. Në Konferencë me vullnetin e tyre dhe jo se i detyroi kush shkuan dhe nacionalistë. Vetëdija patriotike, ndjenja e përgjegjesisë për fatet e vendit ishte motivi që i nxiti dhe i shtyu ata drejt Pezës. Nacionalistët patriotë pjesëmarrës në Konferencë, ishin dy herë më shumë se komunistët. Për nga pjesëmarrja, Konferenca ishte ku vend i vërtetë pluralist, ku morën pjesë nacionalistë të të gjithë spektrit politik, të të gjitha rrymave kryesore të vendit. Kështu rrymat u përfaqësuan me krerët e tyre: komunistët me E. Hoxhën, Y. Dishnicën, M. Gjinishin, K. Tashkon, N. Spirun etj. dhe zogistët me A. Kupin e M. Bajraktarin. Gjysma e pjesëmarrësve përfaqësonin rrymat e tjera nacionaliste, të lidhur ose jo deri në atë kohë me komunistët dhe me luftën çlirimtare, si M. Peza, M. Xhani, H. Lleshi, Q. Harito, D. Çela, H. Begeja, S. Muço, R. Jarani, A. Cami, M. Juniku, K. Qafmolla, S. Jegeni. Në Konferencë u përfaqësua dhe gruaja shqiptare me N. Xhuglini etj. Nga kjo pjesëmarrje e gjerë e pluraliste, Konferenca kishte legjitimitetin e plotë për të vendosur për çështje që lidheshin me

të ardhmen e vendit.

VENDIMET DHE DETYRAT E KONFERENCËS SË PEZËS

Vendimi kryesor i Konferencës ishte bashkimi i gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësitë shoqërore, nga dallimet fetare, nga origjina krahinore dhe nga bindjet politike, në një organizatë të përbashkët me emrin "Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar". Fronti u ngarkua me këto detyra të rëndësishme: të ngrinte popullin shqiptar në luftë kundër okupatorit për të rifituar pavarësinë e atdheut, të udhëhiqte këshillat nacionalçlirimtare që do të formoheshin si organe luftime në zonat e pushtuara dhe si organe pushteti në zonat e çliruara dhe të rreshtonte Shqipërinë dhe luftën e saj në koalicionin anglo-sovjeto-amerikan. Nga shikimi i procesverbalit të Konferencës si dokumenti bazë, del se aty u hodhën për diskutim probleme të shumta. Por, dy ishin problemet e mëdha, në të cilat u ndal gjerësisht Konferenca: bashkim dhe luftë, ose bashkim për luftë. Për nevojën e bashkimit e të organizimit të popullit në luftë, nuk pati kundërshtime parimore. Për këto qysh në fillim u arrit konsensusi e mirëkuptimi i duhur, që siguroi dhe suksesin

e punimeve të Konferencës. Delegatët të gjithë u shprehën për bashkim. Në diskutimet e lira u sqarua çështja se si do të bëhej bashkimi. Bashkimi do të arrihej në luftë kundër pushtuesit dhe se do të bëhej pa dallim klase, krahinë, feje e ideje. Fronti i përbashkët kishte një qëllim të vetëm: të luftonte pushtuesin e huaj, për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie të re, të lirë e demokratike. Fronti kishte për detyrë të përgatiste popullin për kryengritjen e përgjithshme të armatosur, e cila do të niste e zhvillohej nga njësitit guerile e më pas me çeta. Nga kjo luftë do të dilte Shtabi i Përgjithshëm dhe do të krijohej Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar.

ÇËSHTJA E REGJIMIT POLITIK

Në Konferencë u trajtua dhe çështja e regjimit politik. Të gjithë delegatët u shprehën se regjimi i ri në Shqipëri duhet të ishte regjim demokratik. Në Konferencë u ngrit dhe çështja e Zogut, ku u konkludua që kjo çështje duhet t'i lihej në dorë popullit për të vendosur sipas dëshirës dhe vullnetit të tij. Abaz Kupi, që përfaqësonte në Konferencë zogistët, deklaroi se

(vijon ne faqen 3)



HISTORIA

Rreshtimi i Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan

KONFERENCA E PEZËS NGJARJE E MADHE HISTORIKE

Në Konferencë u trajtua dhe çështja e regjimit politik. Të gjithë delegatët u shprehën se regjimi i ri në Shqipëri duhet të ishte regjim demokratik. Konferenca diskutoi dhe çështjen e Kosovës, ku delegatët njëzëri u shprehën për zgjidhjen në bazë të vetëvendosjes së lirë, si e parashikonte Karta e Atlantikut dhe të drejtën e vetëvendosjes kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera do ta fitonin duke u hedhur në luftë kundër fashizmit

Tetëdhjetëdy vjet më parë, më 16 shtator 1942 u mbledh në Pezë Konferenca e Pezës, që përbën një ngjarje mjaft të rëndësishme dhe të madhe historike për popullin shqiptar. Për nga qëllimet dhe vlerat historike, Konferenca e Pezës është vendimmarrje e njëjtë politike, si Lidhje Shqiptare e Lezhës, organizuar nga Skenderbeu më 2 mars 1444 në Lezhë dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e mbledhur më 10 Qershor 1878 në Prizren.

Qëllimi ka qenë i njëjtë: organizimi i luftës së popullit shqiptar për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Konferenca e Pezës, përbën një ndodhi historike mjaft të madhe në historinë e popullit shqiptar, pasi në të u mbledhën përfaqësuesit e të gjitha forcave politike të vendit dhe përpunuan platformën e përbashkët të luftës kundra pushtuesit fashist për çlirimin kombëtar.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të forcave antifashiste shqiptare, me synim që të formohet një front i përbashkët luftime kundër okupatorit. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacionalçlirimtar.

PROTAGONISTËT

Protagonistë të këtij kuvendi ishin 17 delegatë, përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet. Pjesëmarrësit vinin nga rryma të ndryshme politike. Ndërmjet tyre ishin: Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Is-



mail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço. Nga PKS-hja morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini.

Që të gjithë i miratuan vendimet e Konferencës. Ndërsa Kamber Qafmolla nuk mori pjesë në konferencë. Në

këshillin drejtues u zgjedhën 7 persona: 1. Enver Hoxha, 2. Ymer Dishnica, 3. Mustafa Gjinishi, të tre komunistë, 4. Myslim Peza, 5. Abaz Kupi, 6. Ndoc Çoba e 7. Kamber Qafmolla, që të katër nacionalistë, patriotë pa parti.

VENDIMET E KONFERENCËS SË PEZËS

• Konferenca mori disa vendime të

rëndësishme:

- Krijimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje.
- Mobilizimin e popullit në luftë kundër pushtuesve fashistë
- Ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin.
- Rreshtimin e Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan.
- Krijimin e një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike pas lufte.

Sa për çështjen e rikthimit të mbretit Zog, u vendos që vendimi të merrej pas lufte, nga vetë populli shqiptar. Lidhur me çështjen e Kosovës, u arrit në përfundimin që ajo të zgjidhej pas lufte, duke u mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes.

Në fund të punimeve konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, me kryetar Kamber Qafmollën, sekretar Mustafa Gjinishin dhe anëtarë Ndoc Çobën, Myslim Pezën, Abaz Kupin, Enver Hoxhën dhe Ymer Dishnicën.

Konferenca e Pezës mishëron vlerat më të larta të kombit tonë dhe të unitetit. Për shkak të vizonit të tyre largpamës, burra dhe gra u ngritën mbi interesat e asaj kohe dhe u bënë bashkë për të mirën e kombit që ishte në rrezik. Misioni ynë sot është mbajtja gjallë e mesazheve të kësaj dite, të mesazheve që Konferenca e Pezës ka përcjellë ndër vite edhe tek brezi i ri.

Konferenca e Pezës në çështjen kombëtare

(vijon nga faqja 2)

“unë kërkoj Shqipërinë njëherë e jo Zogun. Në qoftë se populli e do, do ta vendosë”. Në përfundim u arrit marrëveshja se karakteri demokratik i regjimit, që kërkohej nga të gjithë delegatët, të shprehej në fjalët në luftë për “Shqipërinë e lirë, të pandashme, independente e demokratike”. Ndërsa për formën e regjimit, këtë e vendoste populli pas lufte. Qeverisja e vendit gjatë lufte do të kryhej nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtare, të cilat do të shërbenin njëkohësisht si organe të pushtetit të ri dhe si organe të bashkimit, të organizimit e të mobilizimit të popullit në luftë.

Konferenca diskutoi dhe çështjen e Kosovës, ku delegatët njëzëri u shprehën për zgjidhjen në bazë të vetëvendosjes së lirë, si e parashikonte Karta e Atlantikut dhe të drejtën e vetëvendosjes kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera do ta fitonin duke u hedhur në luftë kundër fashizmit. Lëvizja

Nacionalçlirimtare e Shqipërisë nuk do të kursente ndihmën e saj, që në Kosovë të organizoheshin për luftë dhe të krijonin këshillat e tyre nacionalçlirimtare. Vendimet e Konferencës, patën jehonë në zhvillimet politike në vend. Kështu u rritën me shpejtësi radhët e Frontit Nacionalçlirimtar me patriotë nga i gjithë vendi. U shtuan e u zgjeruan njësitë partizane me luftëtarë të rinj nga të gjitha krahinat. Zhvillimet pozitive patën ndikim dhe në arenën ndërkombëtare. Pas Konferencës së Pezës, në dhjetor 1942, Fuqitë e Mëdha Aleate (SHBA, BS dhe Anglia) njohën zyrtarisht luftën e popullit shqiptar dhe Shqipërinë si pjesë të Koalicionit Antifashist Botëror.


PËRVOJË MËSIMESH

Konferenca si ngjarja më e madhe e LANÇ-it sjell një përvojë mësimesh me vlerë në ditët tona. Te kjo ngjarje çdo shqiptar e çdo forcë politike gjen mësim për të kontribuar në zgjidhjen

e halleve e të problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet sot. Peza dhe e gjithë Shqipëria bënë thirrje për të respektuar bindjet dhe përkatësitë politike, shoqërore e fetare, duke u ngritur mbi pasionet dhe interesat e vogla, siç u ngritën burra e gra të mençur 79 vjet më parë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet që ka sot vendi. Shqipërisë i duhet sot më shumë se kurrë mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe bashkëqeverisja.

Për interesat kombëtare duhet të lëmë mënjane mosmarrëveshjet, grindjet dhe mëritë, çdo gjë që bie ndesh dhe dëmton luftën dhe përpjekjet për stabilitet e zhvillim. Ky mesazh vjen nga Konferenca historike e Pezës. Këtë duhet ta ndiejë si nevojë e si detyrë çdo shqiptar, çdo patriot e çdo forcë patriotike, pavarësisht nga pozicioni dhe orientimi ideologjik që ka. Shqipëria është e të gjithëve dhe të gjithë kanë përgjegjësinë dhe obligimin për ndërtimin dhe përparimin e saj.

KUJTIME



Gjenaral Nexhip VINÇANI*

Pas Pezës, “kuvendi” ndërkrahinor në Vinçan

• *Aty në Pezë njoha dhe u miqësua me Nako Spirun, me Mustafa Gjinishin, të cilët do t'i takoja përsëri për të fundit herë në Kongresin e Përmetit. U takova dhe u njohëm me Abaz Kupin, Kamber Qafmollën, Shyqyri Pezën, Aziz Camin etj, doemos dhe me Feta Butkën. Mlidheshim për bashkim si shqipëtarë dhe na dukej vërtet artificiale ndarja sipas ideologjisë, gjë që nuk e kishte kohën*

Myslimin, e cila do të na shoqëronte gjatë gjithë luftës por edhe pas saj, që do të takoheshim disa herë, do shtroheshim në muhabet, do të thosha hapur, se ai nuk pyeste nëse i vinte mirë ose jo dikujt. Aty në Pezë njoha dhe u miqësua me Nako Spirun, me Mustafa Gjinishin, të cilët do t'i takoja përsëri për të fundit herë në Kongresin e Përmetit. U takova dhe u njohëm me Abaz Kupin, Kamber Qafmollën, Shyqyri Pezën, Aziz Camin etj, doemos dhe me Feta Butkën. Mlidheshim për bashkim si shqipëtarë dhe na dukej vërtet artificiale ndarja sipas ideologjisë, gjë që nuk e kishte kohën; kohën e kish “Bashkimi”, këtë kërkonte Shqipëria. Të krijohej përshtypja sikur me këta pjesëmarrës, ku do të kujtoj Myslim Pezën, Baba Fajën etj, sikur na kishte lindur një nënë, kishim nevojën e njëri tjetrit. Gjithënjë e më shumë më bënin përshtypje fjalët e Myslim Pezës me çiltërsinë, thjeshtësinë, sinqeritetin e tij, vendosmërinë dhe besimin në fitore. Megjithatë pa arsim, të ngjallte respekt për llogjikën e fortë, gjykimet dhe mendimet e drejta... Si është folur edhe më sipër, në të gjithë krahinën e Korçës, por sidomos në Rëzë, Gorë, Fushë-Korçë, Mokër e Opar, ndërsa nuk kishim ngritur Këshillat NÇI në fshatra dhe krahina, kishim hedhur bazat për një punë të tillë. Megjithatë, gatishmëria që gjetëm mbas Pezës i kalonte parashikimet. Patëm vendosur bashkë me Ymerin, që punën do ta fillonim nga Vinçani, mbasi për këtë kishim sigurisht përgatitjet dhe mbështetjen më të madhe. Tashmë nuk ishte fjala për të mledhur një kuvend në fshatësi e për të zgjedhur një këshillë, ishte fjala për një “Kuvend” të hapur legal me pjesëmarrës nga të gjitha krahët, ku do të merreshin vendime të rëndësishme, që do të kishin, dhe në fakt patën rëndësinë e një Kuvendi ndërkrahinor, i cili u realizua më 16 Shtator 1942.

Në Kuvend, ashtu siç pritej, hasëm në rezistencë, ku u ngrit dhe teza se fshati mund ta pësonte nga forcat armike, por në fund u bindën të gjithë. Nga kuvendi u zgjodh Këshilli NÇI i fshatit dhe u muar vendimi për formimin e Çetës së armatosur të Rëzës dhe njësitin e armatosur të fshatit. Mbas dy ditësh formuam çetën në fjalë, ku u lexua dhe një rezolutë, përmbajtja e së cilës është e shkruar në historikun e fshatit Vinçan. Me Ymer Dishnicën, të nesërmen dhe të pasnesërmen, bëmë të njëjtën punë në Goskovë-Lart e në Polenë. Pas kësaj, Ymeri u largua për punë të tjera në Korçë, ndërsa unë, i shoqëruar nga Çeta e Gorës dhe Çeta e porsaformuar e Vinçanit, u muarrëm me Kuvendet në fshatrat e tjerë të Rëzës e Fushës, ku bëhej zgjedhja e Këshillit, regjistrimi i efektivit të njësiteve dhe më kryesorja, solidarizimi me vendimet e Konferencës së Pezës. Ne hynim në fshat në krye të dy çetave që na shoqëronin me Flamurin Kombëtar në krye duke kënduar këngë patriotike. Në ato kohë, shoqërimi nga çetat e armatosura kishte shumë rëndësi sepse krijonte një atmosferë emocionale. Kjo punë vazhdoi në fshatrat e Gorës e Oparit, për të mos u ndalur më në gjithë krahinën... Intermexo: Që në vitin 1988, bashkë me Samiun (vëllai i N.), i kemi dërguar Institutit të Historisë vërejtjet tona lidhur me tekstin “Lufta Antifashiste Nacional

Çlirimtare në Qarkun e Korçës”. Natyrisht është çensurimi envero-komunist që i ka penguar autorët të shprehen me vërtetësi e objektivitet, në ndonjë rast edhe nga njohuritë e kufizuara të autorëve, sidomos nën diktatin e atyre që thoshin: “Historinë do ta bëjmë si do Partia e jo si thonë dokumentet”. Ka ndonjë historian, bile dhe me tituj shkencorë, që kërkon t'i mbushi mëndjen lexuesve se në Shqipëri, por dhe në Gorë ka pasur Këshilla NÇI të ngritura para Konferencës së Pezës. Kështu sajohej “zgjedhje të Këshillave NÇI në fshatra të Gorës”, por nuk na thonë ku dhe kur u mlodhën zgjedhësit, kë zgjedhën etj; natyrisht këto nuk i thonë, sepse nuk ekzistojnë.

Pavarësisht se Këshillat, në periudhën që bëhet fjalë, nuk kane ekzistuar, “autorët shkencorë” duhet të kishin shkruar atë që është e vërtetë: Jo idetë komuniste, jo celulat e partisë në Gorë e Opar, por traditat patriotike, mbështetja në patriotë me influencë, jo doemos nga më të varfërit e të këputurit, por pa paragjykitime klase shoqërore, pra Go-

rarët, Mokrarët, Oparakët, Fusharakët etj. kanë menduar çlirimin kombëtar por natyrisht dhe për një regjim demokratik që punon për të mirën e popullit. Mendojmë se ato celula partie që kanë mbajtur parasysh si kryesore luftën kundër pushtuesit për një Shqipëri të lirë e demokratike, jo luftën klasote revolucionare, i kanë kryer mirë detyrat ndaj Shqipërisë... Në thelb, LANÇ ka qënë një luftë atdhetare, një luftë për të fituar pavarësi kombëtare, e si e tillë, patriotizmi nuk është monopol as i të pasurve, as i të varfërve, është i të gjithëve. Tendencat për ta monopolizuar nga njëra klasë ose tjetër këtë gjë, nuk bën tjetër, veç dobëson frontin e përbashkët kombëtar duke e përçarë shoqërinë.

*Kujtime nga Konferenca e Pezës të Gjenaral Nexhip Vinçanit “Nderi i Kombit”, ish komandant i forcave të armatosura të Qarkut Korçë, komandant i Br. IVs, zv. Shef i Shtatmadhorisë, anëtar themelues i OBVL. Marrë nga libri “Vinçanët” me autor S.Vinçani dhe A.Kotini



IN MEMORIAM

Gjeneral Rrahman Parllaku ishte dhe do të mbetet një personalitet i madh i kombit shqiptar

Pesë vjet pa gjeneral Parllakun-“Nderi i Kombit”

Kolonel Trifon LLUPO
Nënkyetar i OBVL

Pesë vjet më parë, më 15 Shtator 2019 pushoi së rrahuri zemra mëse 100 vjeçare e Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit.

Me jetën e tij prej më se një shekull, Ai i dha vendit shumë më tepër seç mori prej tij, me ndershmërinë, trimërinë, shpirtmadhësinë, përkushtimin, fisnikërinë, atdhedashurinë për mbarë trojet shqiptare, por edhe me pamjen fizike të një kreshniku që e karakterizonte.

Ai ishte dhe mbetet modeli i të gjitha vlerave dhe virtyteve të Kombit Shqiptar.

Duke qenë një personalitet me jetë të gjatë dhe me këto veti e virtyte, jeta e tij kaloi me shumë tallaze, por kurrë Ai nuk u përkul, por u qëndroi burrërisht, nuk e njohu kurrë ndonjëherë dekurajimin dhe demoralizimin.

Pra kuraja, durimi, shpirti i sakrificës dhe guximi ishin “armët” me të cilat Ai i përballoi tallazet e jetës tij pa u thyer asnjëherë, gjatë gjithë jetës së tij shekullore. Me këto “armë” Ai përballoi aksionet e Njësiteve guerile në Vlorë si dhe betejet luftarake me fashisto-nazistët deri në çlirimin e plotë vendit, ditë, të cilën ai e festoi në Kosovë sepse drejtonte luftimet si Komandant i Divizionit të V-të, në ish Jugosllavi, duke e rreshtuar e futur Shqipërinë në Frontin e madh të Aleancës Anglo-Sovjeto-Amerikane, në Luftën e Dytë Botërore.

Gjeneral Rrahmani, në çdo rrethanë që u ndodh edhe kur u godit poshtërsisht duke e mbyllur pas hekurave me 25 vjet burgim, kur doli nga burgu nuk predikoi kurrë hakmarrje, por Ai ka treguar një tolerancë të rrallë. Ai kur doli nga burgu i Burrelit, i ka takuar personalisht hetuesit e gjyqtarët që e dënuan, sepse Ai ishte i bindur në pafajësinë e vet dhe këta prokuror e gjykatës ishin urdhëruar nga partia, pra zbatonin urdhrin e partisë për dënimin e grupit të ashtuquajtur puçist në Ushtri. Këtë të vërtetë dhe fakt tashmë e ka bërë publik edhe Prokurori i Përgjithshëm i diktaturës komuniste Rrapi Mino, i cili në disa numra radhazi, në gazetën Panorama ka deklaruar se për Grupin puçist të Ushtrisë nuk kishte asnjë fakt e provë për tradhti ndaj Atdheut, por ishte gjyq politik. Me këto deklarime Rrapi Mino konfirmoi Vendimin e drejtë të Gjykatës së Kasacionit në vitin 1994, kur Trupi gjykues dha vendimin për pafajësinë e plotë të Gjeneral Rrahmanit, duke ia kthyer të gjitha çka i ishin hequr: Titujt, Urdhëratë e Medaljet. Unë, që po shkruaj këto radhë për Gjeneral Rrahmanin, e kam njohur këtë Personalitet legjendar, që në vitin 1972, kur shërbeja në Drejtorinë e Zbulimit të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Gjenerali ishte Zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura deri në Gusht të vitit 1974. Nga detyra që kisha në Drejtorinë e Zbulimit, me Gjeneralin takohesha çdo mëngjes sapo fillonim punën dhe ishte një fat i madh për mua që m'u dha mundësia të punoj edhe njëherë me këtë gjeneral, edhe më nga afër, si sekretar i OBVL, gjatë kohës që Gjeneral Rrahmani drejtoi për 20 vjet Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

Kushdo që ka punuar dhe e njohu nga afër Gjeneral Rrahmanin, shpesh është detyruar t'i bëjë pyetjen vetes se a mund të ketë ndonjë 100 vjeçar në të gjithë globin, që të rrezatonte aq energji e freski intelektuale dhe kujtesë brilante, i cili me aftësi e njohuri poliedrike i jepte zgjidhje çdo problemi sado i vështirë dhe i koklavitur. Gjenerali konkludonte drejt sepse Ai i përmbahej një rregulli, të cilin e kishte bërë normë personale.

“Unë, - theksonte shpesh Gjenera-



li, kur intervistohet nga gazetar të ndryshëm për probleme dhe çështje nga më të ndryshmet, flas dhe gjykoj vetëm për ato ngjarje dhe problem që i kam parë dhe jetuar vetë dhe nuk flas dhe komentoj mbi bazën e të thënave apo të dëguara”.

Jeta dhe Veprimtaria e Gjeneral Rrahmanit i përket disa periudhave historike të Shqipërisë. Ajo përfshinë periudhën e Mbretërisë deri në vitin 1939, - Periudhën e Luftës Nacional Çlirimtare 1939-1944, Periudhën e diktaturës komuniste 1944-1990 dhe Periudhën e Demokracisë 1991-2019, ku në çdo periudhë historike të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar Ai ka dhënë kontributin e tij të vyer, duke i qëndruar dhe i shërbyer vetëm Popullit shqiptar dhe Kombit shqiptar.

Kur shprehem se Ai i ka shërbyer

Kombit Shqiptar, kam parasysh se ai ishte një ndër 4 komandantët e njësiteve më të mëdha, gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, pra ishte komandant i Divizionit të V-të, që zhvilloi luftimet jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë, në Kosovë e deri në Vishegrad, duke ndjekur këmba-këmbës bishën naziste dhe duke kontribuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Gjeneral Rrahman Parllaku ishte gjenerali i vetëm i gjallë i Luftës Dytë Botërore, i cili e kaloi shekullin dhe arriti edhe vitin 2019, në shekullin 21. Ai do ishte një monument i gjallë i krenimit të 80 vjetorit të Çlirimit të Atdheut sepse Ai lindi, u rrit dhe mbeti patriot.

Si për të vazhduar nderimin dhe respektimin e Luftës Nacional Çlirimtare të Popul-

Deri para 5 vjetësh Rrahman Parllaku ishte gjenerali i vetëm i gjallë i Luftës së Dytë Botërore, i cili e kaloi shekullin dhe arriti edhe vitin 2019, në shekullin 21. Ai do ishte një monument i gjallë i krenimit të 80 vjetorit të Çlirimit të Atdheut sepse lindi, u rrit dhe mbeti patriot. Si për të vazhduar nderimin dhe respektimin e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, për të cilën sakrifkoi rininë dhe rrezikoi jetën e tij si 70 mijë bij dhe bija të formacioneve partizane shqiptare, Ai u nda nga kjo jetë dhe u varros më 16 Shtator 2019, datën e mbajtjes së Konferencës së Pezës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të Luftës Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar

lit Shqiptar, për të cilën sakrifkoi rininë dhe rrezikoi jetën e tij si 70 mijë bij dhe bija të Formacioneve Partizane Shqiptare, u nda nga kjo jetë dhe u varros më 16 Shtator 2019, datën e mbajtjes së Konferencës së Pezës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të Luftës Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.



Fluturak Asabella (Vinçani) ishte njeri i idealeve të pastra

Genc Ballanca*

Më 21 shtator do të mbushte 100 vjet nga lindja e tij, por fatkeqësisht, Fluturak Asabella (Vinçani), veterani i LANÇ, anëtar i kryesisë së OBVL, Kryetar i Degës së Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës për liri e pavarësi të popullit shqiptar, për Qarkun e Korçës, nuk arriti të jetonte gjer një shekull, sepse vdekja e ndau nga ne kat. 7 muaj më parë, më 2 Qershor 2024.

Fluturak Avdyll Asabella lindi dhe u rrit në fshatin Vinçan të Rrëzës së Korçës.

Ishte vetëm 16 vjeç kur Shqipëria push-tohej nga fashizmi italian, megjithatë e shohim pjesëmarrës në demonstrimet e patriotëve korçarë më 5-6 prill 1939 duke kërkuar armë për rezistencë ndaj pushtuesit. Plot zjarr dhe energji rinore, i rritur dhe edukuar në mjedisin e një familjeje dhe të një fshati me traditë atdashedëse ai u vu në shërbim të qëndrësës antifashiste qysh në fillimet e saj.

Në vitet 1942-43, atë do ta gjejmë të plotësisht të përkushtuar ndaj veprimtarisë antifashiste duke punuar pa u lodhur për përhapjen e frymës për nevojën e rezistencës dhe zgjerimit të rradhëve



të njësiteve të armatosura të Rrëzës së Korçës.

Në tetor '43 merr pjesë në formacionet e armatosura të UNÇL. Operacioni armik i Dimrit e gjeti në Br.IV's, ku si gjithë të tjerët iu desh të përballojë vështirësitë të jashtëzakonshme të luftimeve, raskapitjes, të të ftohtit, urisë e pagjumësisë.

Në një betejë me focat naziste në Arzë të Devollit plagoset rrëndë. Mjekohet në Slimnicë të Greqisë në spialin partizan të EAM-it, për t'u rikthyer mbas 3 muajsh në formacionet luftarake, tashmë në rradhët e Br. XV's si zv.komisar kompanie deri në çlirim.

Fluturaku i përballoi me nder të gjitha detyrat dhe vështirësitë e luftës për 3 vjet. Megjithëse i vdes i ati dhe Fluturaku ishte i vetmi mashkull madhor i familjes, ai nuk e braktisi luftën deri në fund, ku mori gradën n/toger dhe u nderua me një numër medaljesh e dekoratash. Fluturaku fliste me krenari për pjesëmarrjen në atë luftë, por nuk u pajtua kurrësi me pasojat shkatruese të Diktaturës të mbas çlirimit.

Si shumë të tjerë edhe Fluturaku ëndër-

ronte një Shqipëri të pas luftës me mirëqenje, liri, demokraci, paqe dhe harmoni. Fluturaku ishte nga të parët që kuptoi shkëlqen e idealeve për të cilat u luftua dhe si guximtar dhe i ndershëm që ishte reagoi duke u shprehur haptazi në një mbledhje të oficerave në Delvinë në verë të vitit 1946. Ai ishte i ndërgjegjshëm për pasojat që mund të kishte, por kurrë nuk mund besonte se puna do të shkonte deri aty sa ta arrestonin dhe ta dënonin si armik i popullit. Me dënimin e Koci Xoxes në 1949 u liria, por me gjithë përpjekjet e tija të vazhdueshme, si dhe shumë të tjerë, Fluturaku nuk e reabilituan kurrë. Mbi 40 vjet do ta ndihej i “fyer” e i “poshtëruar” nga kalvari torturonjës prej persekutimit nga Sigurimi famëkq, por ai asnjëherë nuk e lëkundti krenarinë dhe dinjitetin. Edhe pse i lodhur nga moshë dhe tallazet e jetës, ai nuk rreshti së qeni një qytetar aktiv, duke duke kontribuar si Kryetar i OBVL-Korçë, në evidencimin dhe promovimin e vlerave patriotike e morale të popullit shqiptar. Veteranët e OBVL dhe pasardhësit e tyre e vlerësojnë lart Fluturakun dhe ndihen të nderuar që e patën midis tyre.

Unë e kisha shok dhe bashkëluftëtar, shok armësh në formacionet luftarake në Brigadën e IV S., bashkëpunëtor që në formimin e OBVL dhe në vazhdim, në veprimtaritë e saj... Fluturak Asabella (Vinçani) ishte njeri i idealeve të pastra, i idealeve fisnike të drejtësisë dhe barazisë që ëndërronte të realizoheshin mbas mbarimit të Luftës. Por sa ëndërrimtar, aq dhe trim. Qoftë në ballë të luftës, qoftë më vonë në përplasjen me diktaturën, e cila ja “shpërbleu” me mënyrën më mizore. Nuk do ta harroj asnjëherë urtësinë, zemërgjerësinë, mendimin e pjekur e të ekuilibruar të mikut tim Fluturakut, i cili u largua nga ne më 2 Qershor 2024, ne moshën 100-vjeçare.

*Veteran i LANÇ, ish-Kryetar i OBVL Qarku Durrës

BOTIME

Rreth librit studimor “Lidershipi në mjedisin e sigurisë” të Dr. Gjeneralmajor Manushaqe Shehu



Nga Sakip Cami

Disa fjalë për autoren

Dr. Gjeneralmajor Manushaqe Lami Shehu është bijë e fisit Lami të fshatit Sohodoll të Dibrës, lindur në Peshkopi më 5 nëntor 1965, e martuar me Ish deputetin e Kuvendit të Shqipërisë Sali Shehu, nënë e dy fëmijëve.

Ka kryer Akademinë Ushtarake në Tiranë, Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, fakultetin e drejtësisë dhe disa kurse e specializime në Akademitë e vendeve të NATO-s si në ShBA, Britaninë e Madhe, Francë, Gjermani, Turqi etj.

Është e vetmja grua në Shqipëri që mban gradën Gjeneral Majore dhe për dy mandate në detyrën e Zv Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSh.

Është gjithashtu Dokto e Shkencave në fushën e sigurisë. Kohët e fundit ajo ka botuar librin “Lidershipi në mjedisin e sigurisë”

DISA REFLEKSIONE PËR MONOGRAFINË STUDIMORE “LIDERSHIPI NË MJEDISIN E SIGURISË”

Ish Presidenti Alfred Moisiu në parathënien e këtij libri nënvizon se studimet në fushën e lidershipit të mjedisit të sigurisë në literaturën vendase janë të pakta, ndaj mund të them pa mëdyshje se libri: “Lidershipi në mjedisin e sigurisë” i Gjenerale Manushaqe Shehu, përbën jo vetëm një kontribut, por edhe një rast të veçantë të trajtimit të problemit të drejtuesit ushtarak.

Ky libër shfrytëzon literaturën më të mirë botërore dhe atë kombëtare, e gërsheton me përvojën e gjatë të autorit dhe të vetë ushtrisë sonë ndër vite e shekuj dhe arrin të bëhet një manual i shkëlqyer për çdo drejtues ushtarak e civil që kërkon të evidentohet si lider.

Jo rastësisht liderë të mëdhenj botërorë si Ajzenhaueri, De Goli e shumë të tjerë kanë qenë gjeneralë ushtarakë.

Evidentohet mjaft mirë në Shqipëri drejtimi si president republike i Gjeneral Alfred Moisiut në vitet 2002-



www.fjalaelire.com

Nevoja e një lidershipi të mirë në kushtet e sotme

MANUSHAQE LAMI SHEHU

**LIDERSHIPI
NË MJEDISIN E SIGURISË**

monografi

BOTIMET TOENA



Prezantimi i librit “Lidershipi në mjedisin e sigurisë”

Autor
Dr. Manushaqe Lami Shehu



“STUDIMET NË FUSHËN E LIDERSHIPIT TË MJEDISIT TË SIGURISË NË LITERATURËN VENDASE JANË TË PAKTA, NDAJ MUND TË THEM PA MËDYSHJE SE LIBRI “LIDERSHIPI NË MJEDISIN E SIGURISË”, I GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHUT, PËRBËN JO VETËM NJË KONTRIBUT, POR EDHE NJË RAST TË VEÇANTË TË TRAJTIMIT TË PROBLEMIT TË DREJTUESIT USHTARAK

2007.

Ka ndodhur kjo se është vetë shkolla e ushtrisë si teori dhe praktikë, si veprimtari me shembull personal e me betim atdhetar që përgatit njerëz, kuadro e udhëheqës që lënë gjurmë.

Në pjesën e parë të librit, në kapitullin: “Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë” trajtohen konceptet për figurën e liderit, roli i diplomacisë në fushën e sigurisë, jo për të bërë lëshime por për të përfituar resurse për vendin tënd, trajtohen traditat dhe ligjet e trashëguara si dhe nevoja aktuale për të hartuar e miratuar ligje e plane strategjik realë në përputhje me gjeopolitikën ballkanike, europiane e botërore.

Trajtohen parimet e drejtimit dhe cilësitë e liderit, komandantit ushtarak duke vënë theksin në mirëmenaxhimin e krizave dhe fatkeqësive natyrore.

Një lider nuk mund të jetë i suksesshëm pa një komunikim perfekt dhe njerzoz, pa një etikë në komunikim dhe kjo kërkon përveç formimit profesional edhe njohuri të plota në pedagogji dhe psikologji për të arritur në botën e brendshme të njerëzve që drejton e komandon.

Kryefjala e një lideri në paktet për sigurinë është konsensusi, theksohet në pjesën e tretë të këtij libri.

Strukturat e sigurisë kombëtare, të ndërthurura dhe të drejtuara nga një drejtues strategjik me dimension njerzoz janë të destinuara të funksionojnë si një sahat i vërtetë.

Në kushtet e sotme të konflikteve në Ballkan, Europë dhe në botë, roli i liderit merr rëndësi të veçantë.

Nuk bëhet fjalë për lider të fortë autokrat, por për lider vizionar, që të marrë vendime të forta në favor të paqes, lirisë, të të drejtave të njeriut dhe mbi të gjitha në mbrojtje e prosperitetit të vendit e të popullit të tij që i ka dhënë të drejtën dhe besimin për ta drejtuar.

Në botë, në Europë, Shqipëri e Kosovë njihen gra të zonja lidere që kanë lënë gjurmë pozitive gjatë veprimtarisë së tyre.

Gruaja lidere, si nënë, si bashkëshorte, si motër, si shoqe mishëron më së miri dhe ka brenda vehtes aftësi të mëdha drejtuese.

Autorja e këtij libri, Gjenerale Majore Manushaqe

Shehu ka përfaqësuar dhe përfaqëson vlerat më të mira të ushtrisë shqiptare dhe jo vetëm të ushtrisë, por edhe të mbarë kombit tonë.

STRUKTURA E LIBRIT

Qoftë dhe nga një vështrim i përgjithshëm i kësaj monografie, gjithkush do të konkludonte se autorja Shehu sjell një punim të plotë që analizon një informacion të gjerë duke arritur në përfundime me vlera njohëse, bazuar në historinë botërore dhe shqiptare, ku njihen plot shembuj liderësh të suksesshëm.

E kompozuar në pesë kapituj: “Lidershipi dhe menaxhimi i sigurisë”; “Kodi etik dhe rëndësia e tij”; “konsensusi, kryefjala e liderit në pakt me sigurinë”; “roli udhëheqës politik në fushën e sigurisë”, dhe “Ballkani, ndryshimet euroatlantike dhe roli i Shqipërisë”, monografia e gjeneralmajor M. Shehut hedh dritë në përmbushjen sa më mirë të misionit dhe të rolit të forcave të armatosura shqiptare në të gjithë historinë 111 vjeçare të shtetit, për të kontribuar në sigurinë kombëtare të vendit. Në të reflektohet më së miri përvoja e saj në krye të korpusit të oficerëve të lartë si numri dy i Forcave tona të Armatosura. Që në hyrje të studimit të saj skrupuloz ajo argumenton se të drejtosh do të thotë të kesh vizion të qartë për sa i përket synimeve dhe arritjeve dhe se udhëheqja është para së gjithash një përkushtim sublim për t'i shërbyer me përgjegjësi interesave kombëtare. Në këtë optikë, nisur nga koncepti i përgjithshëm për figurën e liderit ajo shkruan se: “...është pikërisht lidershipi i nivelit strategjik, që kapërcen vështirësitë, duke orkestruar ngjarjet e brendëshme, në bashkërendim me ndikimin personal të organizatës në mjedisin e jashtëm, me qëllim arritjen e vizionit të organizatës” (fq.22). Me tej ajo argumenton më së miri se si dinamikat e proceseve të buxhetimit të shtetit ndikojnë fuqimisht në vendimarrjen në nivel strategjik.

Përsa i përket rëndësisë së Kodit Etik, autorja e kësaj monografie shumëvlerëshe e konsideron atë një “armë të fuqishme” në duart e drejtuesit, i cili duhet ta përdorë në funksion të krijimit të një mjedisi të këndshëm dhe një klime të favorshme komandimi.

LIBRI

Atdhédashuria, si lajtmotiv, edhe në gjashtë librat e tij të mëparshëm

Hysen Dervishi për “LUFTËTARIN E LIRISË” Rrahman Dervishi

Rrahman Avdi Dervishi vjen në këtë libër i skalitur me vijat e një portreti që për disa studjues dibranë, nuk ishte i panjohur, por jo i studiuar sa duhet, ashtu siç e meritonte, sepse ai ishte mjaft ndikues në rrjedhën e ngjarjeve, në të cilat kishte qenë ose inicues, ose inspirues, ose të dyja bashkë

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Në këtë vit të jubileut të lavdishëm të 80-vjetorit të çlirimit të atdhetut nga okupatori nazifashist, evidentimi i luftëtarëve të lirisë (të të gjitha kohërave), është shërbi mi më i mirë që i bëhet historisë sonë kombëtare.

Në këtë kuadër, shkrimtari tashmë i mirënjohur Hysen Dervishi, është një nga kontributorët shembullorë, vepra e të cilit mund t'i shërbejë (dhe duhet të konsiderohet) nga Komisioni i rishkrimit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave.

Libri i 7-të, i këtij autori, me titullin sinjifikativ “LUFTËTARI I LIRISË” është një prurje interesante në fondin e letërsisë sonë dokumentare. Ndonëse në epiqendër të kësaj monografie është luftëtari dhe patrioti dibran Rrahman Avdi Dervishi, në tërësinë e saj gëlon historia e Dibrës, e shkruar përmes pushkës dhe mendjes së hollë, të cilat, siç shkruan autori në hyrje të librit, e veçojnë atë prej krahinave të tjera, si një zonë me tradita të veçanta.

Atdhédashuria, si lajtmotiv i Hysen Dervishit edhe në gjashtë librat e tij të mëparshëm, (të botuar dhe promovuar bujshëm në harkun kohor të dy dekadave të fundit): “Krenaria”; “Dibra – zemra e kombit”, “Përmbledhje me poezi”, “Vjeshtë e përgjakur”, “Nostalgjia e vendlindjes” dhe në poemën homerike “Dibra – Zani i Shqipes”, tek “Luftëtari i lirisë”, vjen në përmasat biblike të kësaj vepre. Kjo për faktin se ajo e nje lexuesin me “atdhetarë të shquar që u rritën dhe u kalitën me ndjenjat e patriotizmit përmes të famshmes ‘Oda e Dibrës’, e cila kaliti burra me nam e lavdi të madhe, si Elez Isufi, Suf Xhelili, Vehbi Dibra, Ismail Pasha, Seit Najdeni, Dine Hoxha, Llan Kaloshi, Mersim Dema, Sheh Mustafa, Sheh Sula, Iljas Pasha, Isuf Murja, Cen Leka, Cen Daci, Mahmud Daci, Ramis Daci, Halil Daçi, Asllan Kaziu, Murat Kaloshi, Tush Lleshi, Sali Markja, Sal Demiri, Dan Cami, Shaban Cami, Hoxhë Buci, Avdi Dervishi, Lam Bruçi, Asllan Bushi, Shar Topalli, Bajram Hasa, Hoxhë Bodini, Shaban Xhaferri, Has Kalia, Ahmet Perhati, Jashar Lela, Llan Elezi, Mal Llani, Lik Abazi, Kurt Ag Kadiu, Zenel Vata, Kros Vata, Ahmet Koka, Ahmet Begu, Haxhi Lleshi, Dali Ndreu, Ahmet Cami, Nikollë Kaçorri, Selim Rusi, Shaqir Jege-ni, Baftjar Doda, Aqif Lleshi, Esat Ndreu e shumë burra të tjerë, të cilët nën ndikimin e vazhdimësisë heroike

të kryegjeneralit dibran, Elez Isufi, rrokën pushkët dhe iu prinë dibramëve në disa luftëra, kuvende, kryengritje, duke u bërë preludi i fitoreve të njëpasnjëshme për çlirimin dhe ruajtjen e kufijve të shenjtë”. (fq. 5-6).

MONOGRAFI QË I NGJAN NJË ESSEJE TË GJATË HISTORIKE

Ndonëse në tërësinë e saj kjo monografi i ngjan një esseje të gjatë për kuvendet e Dibrës, kongreset e saj, ngjarjet e rëndësishme historike të zhvilluara në zona të ndryshme, në fokusin e autorit është luftëtari e patrioti Rrahman Avdi Dervishi nga Lukani i Katër Grykëve të Dibrës.

Referuar gjeografisë historike si disiplinë fundamentale shkencore, Hysen Dervishi e trajton këtë personalitet dibran të integruar me faktorët kompleks dhe ngjarjet historike që ndikuan në formin e tij atdhetar e patriotik. Sepse ai i përket fisit Dervishi të Lukanit që gjithnjë është shquar për trimëri, besë, urtësi e mençuri, i përket njëres prej familjeve të këtij fisi të trashëguar nga breza që e provuan veten në betejat të përgjakshme dhe nuk u dorëzuan, nuk u gjunjëzuan. Në formimin e tij, pa dyshim që ka ndikuar i jati, Avdi Dervishi, i cili sëbashku me dy vëllezërit, Selmanin dhe Hysenin, e dhanë jetën për kombin dhe atdheun e shtrenjtë që e deshën më shumë se gjithshka.

“Avdi Dervishi u vra në Petrinë të Ohrit, duke lënë pas tij kullën historike, prej së cilës u renditën brezat e tjerë të revolucioneve popullore, dhe gruan e tij Mihanen, bija e Nuzajve të Shlliuat dhe mbesa e Kokës në Macukull, bashkë me tre djemtet e tij Mehmetin, Rrahmanin dhe Seitin”, shkruan autori në këtë libër. (fq.62). Dhe jo pa qëllim veçanërisht djalë dhe dytë të Avdiut, Rrahman Dervishin, i cili lindi në vitin 1908 dhe ishte vetëm 5 vjeç kur i vdiq babai nga pesë plagë të marra në tetor 1913 në betejën e famshme të Petrinës. Rrahmani do të burrërohej para kohe e frymëzuar jo vetëm nga vepra heroike e babait, por edhe nga gratë trimëresha të Dervishajve që: “së bashku me fëmijët e vegjël në shalën e kalit, morën rrugën e sprovës së madhe për në Prizren, ku prodhimi ishte si askund tjetër”. (fq. 65)


Libri monografik “Luftëtari i lirisë” i autorit Hysen Dervishi është shprehje më e mirë e ndëveprimtimit të kauzave patriotike të Rrahman Dervishit, me të cilat lidhet jo vetëm një pjesë e madhe e veprimtarisë së tij atdhetare, por edhe fati i jetës me atë të atdheut. Nga ky libër mësojmë se si luftëtari e patrioti dibran Rrahman Avdi Dervishi mbindërtoi gjithë formimin e tij intelektual e patriotik. Mbështetur në kauzën e lirisë.

SINTEZË TË DHËNASH E DËSHMISH MBI NJË PERSONALITET TË VEÇANTË

Libri monografik “Luftëtari i lirisë” është një sintezë të dhënash e dëshmish mbi një personalitet sa të veçantë, aq edhe kompleks, sa origjinal aq edhe kreativ, për nga natyra dhe energjia vepruese në rrethana e kohë të ndryshme. Rrahman Avdi Dervishi vjen në këtë libër i skalitur me vijat e një portreti që për disa studjues dibranë, nuk ishte i panjohur, por jo i studiuar sa duhet, ashtu siç e meritonte, sepse ai ishte mjaft ndikues në rrjedhën e ngjarjeve, në të cilat kishte qenë ose inicues, ose inspirues, ose të dyja bashkë.

Këtu nuk mungojnë të gjitha “stacionet” jetësore nëpër të cilat kishte kaluar Rr.Dervishi, që nga lindja më 1908 në fshatin Lukan e në vijimësi kur: “...në vitin 1920, ndonëse shumë i ri, u përball me betejat e burrërisë shqiptare kundër fashizmit Italian, duke parë me sytë e vet heroizmin e vlonjatëve, por edhe të burrave të Dibrës, si Lam Bruçi me shokët e vet, i cili u hodh i pari në llogoret e betejës dhe u plagos e lau me gjak ato telat me gjemba të heroit të Vlorës Selam Musai...”

Autori ka ndjekur hap pas hapi rrugëtimin e Rrahman Dervishit në kohë e hapësirë, duke filluar nga rinia e hershme e tij e deri në momentet e fundit të jetës (vdiq me 11.3.1981). Në këtë ecejake të gjatë, lexuesi arrin të shoh si në një shirit filmi zhvillimin dhe formimin e një personaliteti, i cili gjatë rrugëtimt jetësor do të bëhej protagonist i ngjarjeve historike. Kështu “Njësi të parë partizan i Dibrës, i formuar në shtëpinë e Rrahman Avdi Dervishit në Lukan, nën udhëheqjen personale të Haxhi Lleshit, luajti një rol tepër të rëndësishëm në zgjimin dhe mobilizimin e




popullit në luftën partizane”. (fq. 111).

Gjithësesi, profili jetësor i Rrahman Dervishit do të dilte i paplotë nëse autori nuk do të evidentonte besnikërinë e tij ndaj idealeve antifashite dhe patriotike, duke u rreshtuar në Çetën e Dibrës dhe më vonë në batalionin partizan, si pjesëmarrës në shumë luftime, duke mbetur përgjithnjë një figurë luftarake historike, besnike e çeshtjes kombëtare, që nga janai 1941 deri në nëntor 1944, kur u çlirua Shqipëria.

Nga ky libër mësojmë për veprimtarinë e tij të shtrirë në një hark të gjerë kohor, me një shtrirje të gjërë territoriale dhe një rrjet bashkëpunëtorësh, si përgjigje ndaj sfidave të kohës që vepro. Autori Hysen Dervishi e prezanton si të tillë këtë personazh historik edhe në vitet e pas çlirimit, kur Rrahmani i besuan dhe kreu me devotshmëri detyra shtetërore dhe shoqërore. Ai evidenton kontributin e Rrahman Dervishit për atdheun, vendlindjen, shoqërinë dhe familjen, zgjuarsinë e tij natyrale dhe vizionin për të ardhmen. E veçanata e këtij libri monografik është se autori, krahas portretizimit sa më besnik të figurës së Rrahman Dervishit, ka sjellur edhe një vështrim panoramik të historisë së krahinës prej nga vjen ai, Lukani i katër Grykëve të Dibrës, duke ofruar të dhëna të vlefshme trugut të tij familjar. Si i tillë, ky libër monografik, përveç që plotëson një boshllëk në tërësinë e informacioneve tona, ai i shërben edhe qëllimit të rishkrimit me vërtetësi të historisë, (ri) vlerësimit të personaliteteve të saj, process ky që i shërben kompletimit dhe sistemimit të të dhënave arkivore dhe vendosjen e tyre në një rrafsh studimi të paanshëm.

PAK RADHË PËR AUTORIN HYSEN DERVISHI

Referuar vlerësimit të analistit dhe poetit të mirënjohur Dukagjin Hata, shkrimtari Hysen Dervishi, edhe me këtë libër, vjen si një nga kërkuesit më të pasionuar të psikologjisë dhe shpirtit dibran, duke iu drejtuar vetëdijes kolektive të një populli me rrënjë të ngulura thellë në histori, i cili e shkroi sagën e fiseve krenare e të panështruara ndaj të huajve, në lëvoren e pemës vigane të kujtesës sonë. Me shtatë librat e tij ai zë vend të dinjitetshëm në fondin e artë të letërsisë shqipe. Kjo për faktin se firmën e Hysen Dervishit mbajnë monografi e poezi, portrete e analiza ku lëvrijnë ngjarje e personazhe të historisë sonë kombëtare. Ai ngre në pedestalin që meritojnë, jo vetëm personalitetet dibrane me rrezatim mbarëkombëtar në histori, që nga Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, origjinën dibrane të të cilit të mirëargumentuar nga shkrimtari Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, më së fundi e deklaruan edhe autoritete zyrtare turke, Qemal Ataturku – strategu i madh i revolucionit xhonturk me origjinë nga Koxhaxhiku i Dibrës; Nikollë Kaçorri nga Krej Lura e Dibrës, filozof dhe politikan me prirje përparimtare – nënkryetar i qeverisë së Ismail Qemalit; Iljaz Pashë Dibra – Kryetar i Lidhjes shqiptare të Prizrenit, Dine Hoxha i Muhurrit të Dibrës, politikan dhe diplomat i shquar, këshilltar i Mbretit Zog dhe prijës e udhëheqës i kryengritjeve popullore kundra serbëve., por edhe elitën krijuese dibrane me përfaqësues dinjitozë si Haki Stërmilli, Hazis Ndreu – Nderi i Kombit; Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, Ahmet Prençi, ndër poetët e prozatorët dibranë, krijimtaria e të cilit vlerësohet krahas më të mirëve personalitete të letrave shqipe, ashtu si edhe akademik Shaban Sinani, Xhafer Martini, Agron Tufa e dhjetra te tjerë, që në fushën e letrave, artit e kulturës u lënë trashëgim brezave krijimtari letrare kaq shumë të vlerësuar.



REPORTAZH

VIÇISHTI, fshati që ka më shumë heronj e dëshmorë se sa shtëpi

Diaspora, festë në fshatin e martirizuar

Halil RAMA -Mjeshtër i Madh*

Viktimë e vendimit famëkeq të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të 1913-ës, që edhe fshati Viçisht i Dibrës, gjysma e njerëzve të gjakut e fiseve të të cilit mbetën në Dibrën e Madhe, si edhe të disa zonave tjera kufitare që ju aneksuan ish-Jugosllavisë. Për afro një shekull, u ndanë për së gjalli njerëz e familje të një gjaku e fisi.

Dhe si të mos mjaftonte kjo tragjedi njerëzore, sërish sistemi i diktaturës do të ndiqte politika përçarëse edhe për banorët e këtij fshati me histori të lavdishme.

Një ndër rastet e shumta të këtij kalvari është edhe Hasan Cami, ish bashkëluftëtar i Heroit të dy luftave Botërore Ahmet Cami, që me krijimin prej tij të çetës antifashiste të Gollobordës. Edhe Hasani ishte ndër 19 burrat e këtij fisi që për veprimtari patriotike u burgosën nga fashistët italianë në burgun famëkeq të Tiranës në prill 1941 (mes të cilëve katër pushkatohehen dhe tetë të tjerë bien dëshmorë), por çuditërisht, ky pinjoll i këtij fisi emërndritur, pas çlirimit arrestohet dhe dënohet me akuzën absurde të sajuar nga ish sigurimi famëkeq i shtetit diktatorial "agjitacion e propagandë", dënim ky që do t'ju kushtonte rëndë edhe pjestarëve të familjes së tij që u persekutuan për vite e dekada të kohës së monizmit.

EMIGRANTI NGA VICISHTI, SI FAKTOR PËRBASHKIMI

Tetëdhjetë vjet pas atij akti barbar, Klodian Cami, (stërnipi i patriotit Hasana Cami), President i Shoqatës "Shqiponja" (të emigrantëve shqiptarë) në Reggio Emilia të Italisë, identifikohet si faktor përbashkimi, jo vetëm i Camëve, por i gjashtë fiseve: Cami, Lika, Xheka, Tola, Suma, Markja e Izvira, duke iniciuar dhe organizuar një festë madhështore mbrëmjen e 17 gushtit në oborrin e shkollës "Fasli Cami" në Viçishtin e Epërm, një fshat ky me bukuri të rralla natyrore, në preherin e maleve. Dhe jo vetëm kaq, por siç do të shprehej me fjalën e tij artistike moderatori i këtij eventi, Mjeshtri i Madh Defrim Methasani: "Të gjithë ndjejnë kënaqësi dhe krenari njëherësh që janë pjesë e kësaj feste madhështore në fshatin që ka më shumë heronj e dëshmorë se sa shtëpi, në fshatin që ka nxjerrë dhjetra personalitete me rrezatim mbarëkombëtar, si ministra, deputetë drejtues institucionesh kryesore qëndrore, apo dhe kampione Europe e bote në sporte të ndryshme, si vëlla e motër Tefta e Mojs Cami. Shkrimtarët e njohur Sakip, Shpëtim e Agron Cami, drejtoresha e QSU Tiranë, Prof. dr. Alma Cani, kampioni i botës në boks Adriatik Cami etj.

Po. Është vërtetë kënaqësi për mjeshterin e moderimit dhe ikonën e gazetarisë sportive e të dokumentarit televiziv Methasani, të jetë pjesë e kësaj feste dhe ta moderojë atë, një traditë që po zgjerohet nga viti në vit me kthimin e mërgimtarëve në vendlindje, investimin dhe kujdesin e tyre për aktivitet të bukura si ky i sotmi. Këtë kënaqësi dhe krenari do ta shprehë edhe kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri. Në fjalën e saj përshëndetëse ajo e konsideron Viçishtin një fshat me traditë të hershme kombëtare, me dëshmorë dhe heronj të shumtë, për shkak të natyrës dhe ndjenjës së fortë kombëtare, por

TEFTA CAMI: T'i japim fund emigracionit! Pasuria, e ardhmja e çdo shqiptari është këtu në Shqipëri, sepse Shqipëria ka pasuri pafund tokësore e nëntokësore, klimë e turizëm malor e detar. Shqipëria do të bëhet vetëm me punën e përkushtimin e shqiptarëve. Vetëm në Shqipëri shqiptarët ndihen të barabartë e me dinjitet për punën që bëjnë. Vetëm në Shqipëri do të ndihen krenarë"

edhe me të përndjekur politikë dhe me personalitete në fushën e arsimit dhe shkencës, dhe kjo histori ja shton përgjegjësinë për të bërë më shumë për infrastrukturën e mjedisin e këtij fshati Qytetarja e parë e Bashkisë Bulqizë, znj. Festime Mjeshtri tha se e mirëpriti menjëherë ftesën për t'ju bashkuar dhe për të kontribuar për ta rregulluar shkollën që mban emrin e dëshmorit "Fasli Cami", për këtë ditë festive. Ajo është edhe ish - nxënëse e kësaj shkolle, kështu që përgjegjësia e saj që e shumëfishu, siç pohuan edhe organizatorët tjerë të kësaj feste. Duke përgëzuar Klodian Camin për jetëzimin e mallit dhe dashurisë për familjen dhe mbi të gjitha për institucionalizimin e kësaj feste, ajo ftoi banorët e 63 fshatrave të bashkisë Bulqizë të marrin shembullin e Viçishtit dhe ta shikojnë bashkinë si partnere.

I pranishëm në këtë festë edhe deputeti demokrat Xhelal Mziu, ndërsa prshëndeti qindra pjesëmarrësit e në veçanti bijtë emigrantë të këtij fshati, mirënjohje të veçantë shprehu për Klodian Camin. Ai tha se ishte i entuziazmuar që ndodhej mes banorëve të fshatit historik të Viçishtit, në juridiksonin e njësisë administrative Gjoricë. Mziu vlerësoi egon e jashtëzakonshme të Klodian Camit për të maksimalizuar dhe transmetuar tek bashkëmoshtarët e tij çdo vlerë të Shoqatës "Shqiponja" në Reggio Emilia që ai ka themeluar dhe drejton prej dy dekadash (Ai është edhe sponsor i ekipit të futbollit "Shqiponja" që këtë vit arriti në kategorinë C1.).

DY MESAZHET E ISH MINISTRES SË ARSIMIT Tefta Cami

Qindra pjesëmarrësit që kishin mbushur oborrin e shkollës "Fasli Cami" ndoqën me interesim të veçantë dhe duartrokitën ngrohtësisht znj. TEFTA CAMI, bijë e këtij fshati, ish ministria më jetëgjatë e arsimit, e cila me vendimarrjen e saj si ministre, ka kontribuar që të ndërtohet kjo shkollë.

Pasi falenderoi organizatorët për ftesën për të marrë pjesë në festën e emigracionit në fshatin e saj të lindjes, Viçisht, dhe pjesëmarrësit e shumtë në këtë festë, ndër të tjera ajo tha se kudo ku ka punuar është përpjekur, që të nderojë familjen e saj me tri breza dëshmorë të atdheut, farefisnin me 14 dëshmorë gjatë Luftës të Dytë Botërore dhe bashkëfshatarët e saj. Ajo evidentoi gjithashtu ndihmën për bashkëfshatarët, duke u ndërtuar e hapur shkollën e mesme "Fasli Cami", për ujësjellësin dhe me të drejta studimi. Znj. TEFTA CAMI përgëzoi inisitorin e organizatorin kryesor të këtij aktiviteti, Klodi Remzi Camin, që është pasardhës i Beqir Camit, i cili ka marrë pjesë gjatë Luftës të Parë Botërore me Shaban e Fet dhe Dan Camin dhe e kanë varë në mes të Sofies Beqirin, si luftëtarë e patriot shqiptarë, që ka luftuar kundër forcave pushtuese serbe e bullgare. Klodi është pasardhës i Hasan Beqir Camit, që ka qenë bashkëluftëtar i komandantit të tij Ahmet Feta Camit, si dhe bashkëluftëtar në burg si antifashist gjatë viteve 1941-1942. "Camet kanë qenë gjithmonë të bashkuar, kur mëmëdheu ka qenë në rrezik nga pushtuesit e huaj në të gjitha luftat, për të mbrojtur vatanin. Prandaj po jap këtë mesazh: Mos shikonit fe e ndarësira, se feja e shqiptarit

është shqiptaria!

Me që është festa e emigracionit, mesazhi i dyte është: T'i japim fund emigracionit! Pasuria, e ardhmja e çdo shqiptari është këtu në Shqipëri, sepse Shqipëria ka pasuri pafund tokësore e nëntokësore, klimë e turizëm malor e detar. Shqipëria do të bëhet vetëm me punën e përkushtimin e shqiptarëve. Vetëm në Shqipëri shqiptarët ndihen të barabartë e me dinjitet për punën që bëjnë. Vetëm në Shqipëri do të ndihen krenarë", tha ndër të tjera ish - ministria e Arsimit TEFTA CAMI.

NË TETOR 80 VJETORI I SHKOLLËS "FASLI CAMI"

Fjalë zemre për këtë djalë të Viçishtit thanë në përshëndetjet e tyre edhe znj. Lirie Teodori, Drejtore e Shkollës "Fasli Cami" dhe Prof. dr. Shpëtim Cami, kryetar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, djalë i këtij fshati dhe

ish - nxënësi i kësaj shkolle. Prof. Cami vlerësoi angazhimin e kryebashkiakes Festime Mjeshtri në mbështetje të Festës së Diasporës së fshatit Viçisht, si dhe përgatitjet për 80 vjetorin e Shkollës 'Fasli Cami', me synim krijimin e një muzeu të shkollës në muajin tetor të këtij viti që përkon edhe me 80-vjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist..

(vijon ne faqen 9)



SPECIALE

FERIDE KURTI VETERANIA E KËNGËS MATJANE

NGA MEVLUD BUCI

Feride Ibrahim Kurti, u lind në Burrel, më 15 shkurt 1935 në një familje autoktone e fisit Kola. Talenti i saj ra në sy që në fëmijëri. Mes prirjeve të moshës ajo-zgjodhi këngën, edhe pse e re, pa i mbushur 10 vjeç. Duket se këtë e mori si ngacmim nga prindërit, Ibrahim e Ishja dhe xhaxhai Sadiku, por më shumë nga gjyshi i saj, Kurti, i cili thoshte se interpretonte dhe këndonte me lauri e çifteli. Kënga e tërhoqi shumë dhe iu përkushtua tërësisht asaj. U ushqye me ajkën e këngës dhe i dha jetë asaj. Këngët lirike “Cucë e bukur moj matjane”, “O florini i vogël”, “Rashë në shartashi” etj, u përhapën me shpejtësi në popull dhe u bënë të njohura, aq sa tërhoqën vemendjen dhe interesin e Radio Tiranës. Që nga viti 1968 ajo u bë ndër këngëtares më të shquara në Mat e në mbarë Shqipërinë, duke pasuruar repertorin aktiv me mbi 60 këngë nga më të bukurat, siç janë: “Cucë e bukur moj matjane”, “Rashë në shartashi”, “Ditë korriku 31,” “O florini i vogël”, “A e mban mend o e vogël-o”, “Liqeni i Ulzës” “Më

shkon rrugës porsira era”, “Kur fillon dielli me ra”, “Lufton Mati për liri”, “Moj ushtria popullore”, këngë kushtuar Vasil Laçit etj.

Më 2 shtator 2023, kur isha në veprimtarinë “Pena Budiane”, më mbeti peng sesi nuk munda të them dy fjalë për të. Ajo është motra e studiuesit të talentuar, arkeologut dhe etnologut Dilaver Kurti, ndërsa mbesa e saj Mimoza Kurti – Sekretare për Marrëdhëniet Publike të OB-VLP po punon intensivisht për jetëzimin e trashëgimisë së tyre, në dokumentarë e veprimtari promovuese.

Të shkruash për këtë artiste nuk është e lehtë pasi ajo ka lënë gjurmë të pashlyera në artin e këngës. Edhe pse është ndarë nga jeta pak kohë më parë kënga e saj nuk ndahet nga zemrat e njerëzve dhe emri i saj gjithashtu.

Feridja bashkë me vëllezërit dhe me motrat, me fisin e saj, ka lënë plot visare në fushë të artit dhe të kulturës. Ajo kishte zërin e kthjellët e të ngrohtë, pasionin e madh dhe të gjitha këto i bëjnë këngët e saj lirike mbresëlënëse.

Që më 1966, ajo u bë një këngëtare e njohur lirike në Mat e në mbarë Shqipërinë. Dhe aktiviteti i saj artistik vi-



joi duke e pasuruar repertorin me mbi 60 këngë. Duke qenë e preferuara e veprimtarive artistike që zhvilloheshin atëhere në Mat e në treva të tjera të Shqipërisë, Feride Kurti arriti të imponohej si zë i rrallë i këngës popullore.

Kompozitorët e njohur si: Skënder Frashëri, Munir Shehu, Naim Gjoshi, Skënder Alia, Ymer Neli, Xhevat Lishi, Shefqet Merrra, i besuan asaj kom-

(vijon ne faqen 13)

Një mal me këngë për luftërat e lirisë, një gjerdan me këngë lirike matjane, që janë të rralla për meloditë dhe vargjet e ndjera, pruri e përcolli viteve Feride Kurti. Në jetën tonë kënga e saj lirike ka vendin e pazëvendësueshëm, që na afron më shumë me sofrën, me të bukurën, me dashurinë, me lirinë e vetvetes. Ajo është motra e studiuesit të talentuar, arkeologut dhe etnologut Dilaver Kurti, ndërsa mbesa e saj Mimoza Kurti – Sekretare por Marrëdhëniet Publike të OB-VLP po punon intensivisht për jetëzimin e trashëgimisë së tyre, në dokumentarë e veprimtari promovuese

Diaspora, festë në fshatin e martirizuar

(vijon nga faqja 8)

Fasli Cami, emrin e të cilit mban kjo shkollë lindi në nëntor të vitit 1912 në fshatin Viçish të Dibrës. Shkollën fillore 6 vjeçare e kreu në Internatin e Kastriotit të Dibrës nga viti 1920 deri në vitin 1926. Më 1927 u pranua në Shkollën Mbretërore. Në vitin 1931 u transferua në gjimnazin e shtetit në Tiranë dhe vazhdoi studimet në këtë gjimnaz deri në fundin e vitit 1932, kohë kur e përjashtuan se kërkoi të drejtën si dhe shfaqja shenja rebelizmi ndaj padrejtësive. Në këtë kohë Fasli ishte në një shkollë me Mehmet Shehun, i cili më vonë në kujtimet e tij do të shkruante se s’kishte takuar në jetën e tij djalë më trim se një dibran me emrin Fasli Cami. Me shumë përpjekje u ripranua për të vazhduar studimet në shkollën normale të Elbasanit. Në janar u emërua mësues, në vitin 1939 u transferua në Gjoricë, ku shërbeu me nder, përgjegjësi dhe ndërjegje deri më 6 prill 1943, deri në momentin kur fashistët italianë e vranë në kodrat e Gjoricës. Mësues e nxënës të Shkollës së Viçishtit, në këtë 80 vjetor të krijimit të saj ndjehen më krenar se kurrë që ajo mban emrin e mësuesit dëshmir Fasli Cami.

Prof. dr. Shpëtim Cami, në fjalën e tij vlerësoi gjithashtu dakortësimin me kryebashkiaken Mjeshtri për ide që duhen mbështetur në çdo fshat, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënive me diasporën dhe emigrantët shqiptarë.

Pjesëmarrësit i përshëndeti gjithashtu kryetari i degës së LID për Maqellarën, gazetari e shkrimtari Osman Gjili, kampioni i botës për dy kategori në boks Adriatik Cami etj.

Mësuesi veteran Avni Mera, ish - drejtor për 8 vjet i kësaj shkolle shprehu kënaqësi të veçantë që ndodheshin mes ish dhjetra nxënësve të tij, sot në profesione e funksione të ndryshme në Bulqizë, Peshkopi, Tiranë e diasporë.

Kënaqësi të veçantë që ndodheshin mes djemve e vajzave viçishtash shprehën edhe nënkryetari i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, z. Musa Riçku, kryetari i degës së PD, avokat Shaqir Manjani, njëherësh anëtar i këshillit të Bashkisë Bulqizë dhe nënkryetari i këshillit të kësaj bashkie Z. Munir Sinani. Në fjalët e tyre, emërues i përbashkët është mirënjohja për Klodian Camin, iniciator dhe organizator i kësaj feste mbresëlënëse. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin “krenari”. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Klodian Cami, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

FESTA E VIÇISHTIT, ME RREZATIM NBARËKOMBËTAR

Festa e Viçishtit rizgjoi nostalgjinë e bnorëve të tij, veçmas atyre që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë. Klodian Cami është njëri prej atyre djemve që kthen kokën pas, duke krijuar mundësinë e gëzimit e bashkimit të njerëzve përmes organizimit të kësaj feste të paparë në fshatin e tij.

Impresione ngjalli kjo festë edhe tek miqtë e tij të ardhur nga SHBA, Italia, Gjermania, Greqia, Gostivari e Dibra e Madhe. “Uroj që kjo festë të përhapet në gjithë Shqipërinë”, thotë Gjentian

Shero nga Kavaja, kryetar i Shoqatës “Nënë Tereza”, në Trento të Italisë, sponsor dhe president i shkollës “Artur Lleshi” dhe ekipit të futbollit “Iliria” të emigrantëve shqiptarë në këtë rajon të Italisë. Urimit të tij i bashkohet edhe Bujar Tabaku, nga Kavaja që jeton në Parma. Ai thotë se me shembullin e tij, me shqiptarizmin e spikatur në drejtimin e shoqatës “Shqiponja”, Kloian Cami është bërë shembull frymëzimi edhe për Forumi e Guas Shqiptare, me presidente znj. Marsida Mediu që është bërë zëri i diasporës në Itali. Gentiani dhe Bujari na flasin me përzemërsi edhe për ndihmësën që Klodian ka dhënë për shkollën shqiptare “Skënderbeu” me drejtor Durim Lika nga Manza dhe mësues Zamira Shkurti nga Lushnja, Sabri Kulla nga Durrësi, shkollë kjo ku mësojnë 65 nxënës, fëmijë emigrantësh shqiptarë. Mirënjohje dhe respekt të veçantë për Klodian shprehën edhe Ibrahim Kolari në emër të diasporës shqiptare në Nju Jork, Miçe Duka, Kryetar i Shoqatës Kulturore Artistike “Dibra e Madhe”, Ismaili nga Gostivari, anëtar i shoqatës “Shqiponja”, Resul Uzini nga Gostivari, si dhe bashkëshortët Sugare dhe Gjovalin Suzaj nga Tropoja, Urimit të tyre të përzemërt për Klodian Camin, djalin e shqiptarisë në Itali i bashkohet edhe kunata e tij, Alma Skuka që ka ardhur nga Franca për të bërë disa foto nga ky fshat perlë e natyrës, si dhe Drita Ahmet Cami (Ibruli) që kishte ardhur nga Gjermania.

“Sa i bukur duket viçishti këtë mbrëmje të 17 gushtit. Ky vend është i shenjtë për ne. Është kënaqësi e veçantë që bëhemi bashkë, në këtë bashkim vlerash...Sonte jemi shumë

më shumë nga sa e mendonim, por duhet të ishim shumë më shumë... Këtu tek kjo shkollë me histori 80 vjeçare nisi sot ky takim që do jetë i përvitshëm”, thotë ndër të tjera i emocionuar protagonist kryesor i kësaj feste, Klodian Cami. Dhe në morinë e miqve të shumtë, përveçon mjekun Bajram Xheka dhe mësuesin veteran Fehmi Lika, ish kryetar i fshatit Viçish, që që dhanë ndihmesë në organizimin e këtij eventi. Atmosferën e kësaj feste e ndezi këngëtarja famoze Elda Berisha me këngën “Kuq e zi”. Jehona e vargjeve të saj “Ose sot ose kurrë/ na bashkon një flamur/ kuq e zi është Shqipëria/ është Kosova, Çamëria” jehuan fuqishëm grykës së Drinit të Zi e matanë kufirit në trojet shqiptare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Po ashtu edhe vargjet e këngës “Po ku ka si ti moj Shqipëria ime”, interpretuar mjeshtrisht nga vogëlushja Keisiana Duriçi, si dhe Evelina Shabani, mbesë e këtij fshati me zërin e saj brilant në interpretimin e këngëve popullore dibrane. Gjallëri i dhanë festës edhe valltarët e vegjël të Qendrave Kulturore të Fëmijëve Bulqizë e Durrës, si dhe artistët e mëdhenj të humorit, Mjeshtri i Madh Behar Mera e Genci Lleshi, me interpretimin e disa grimcave humoristike gazmore.

Gëzim, këngë, valle, hare...në këtë natë festive në festën e Viçishtit, fshatit të martirizuar nga pushtues të shumtë dhe nga diktatura komuniste, festë që mbyllet me zërin kushtrimor të Dritan Jasharit në këngën kushtrimor “Fluturon shqipja mbi Korab..."

*Fotot ilustruese nga fotoreporteri profesionist Agim RAMA

OPINION

HILEJA E NDËRKOMBËTARËVE PËR URËN E IBRIT



SHPENDI TOPOLLAJ

WWW.FJALAEKURE.COM
REVISTA: "ALBANIAN POST" LONDËR

Shpendi Topollaj

SHPENDI TOPOLLA

Lumi Ibër (shqip: i bardhë, shkumbëzon), që buro nga Alpet shqiptare, në rrugëtimin e tij prej 276 kilometrash dhe sidomos ato 82 kilometrat që kalojnë nëpër Dardani, ka qenë dëshmitar prej një kohe të gjatë historike i krimeve dhe mizorive që u janë bërë banorëve të atyre trevave nga ana e pushtuesve sllavë, të paktën qysh nga viti 1185, kur veriu i Kosovës u pushtua nga shteti serb i Nemanjve. Nuk ka qenë vetëm etja për zgjerim, por edhe pasuritë e mëdha, sidomos me argjend e plumb të Albaniut e Trepçes, ato që i nxitën ata pas romakëve dhe bullgarëve të carit Simeon të shekullit të IX - të, për të synuar shkombtarizimin e popullsisë shqiptare, duke e detyruar gjatë mbretërimit të car Dushanit që të ndërrojë edhe fenë; nga ajo katolike, në ortodokse sllave. Por njëkohësisht, kjo politikë dhe përpjekjet për t'i përzënë ata nga trojet e tyre shekullore, deri edhe me raprezalje, vrasje e diskriminime ka bërë që atje të shfaqet me tërë madhësinë e saj atdhedashuria e konkretizuar me lufta të paprera qysh nga shekulli i XVII - të, periudha e Tanzimatit dhe kryengritjet e vitit 1903 e 1912 kundër turqve. U shquan në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit burrat trima si Ali Draga e Mulla Iliazi me shokë, Isa Boletini, Rexhep e Dervish Mitrovica, Hajredin Draga e Tafil Boletini në ngritjen e Flamurit të Pavarësisë dhe shumë të tjerë gjatë luftës së Dytë Botërore që kundërshtuan planet aneksioniste të Jugosllavisë Titiste. Ndaj gjithkush e kupton turpin dhe paradoksin e quajtjes deri në vitin 1991 të këtij qyteti Mitrovica e Titos. Asnjëherë banorët e Mitrovicës nuk janë pajtuar me padrejtësitë që ai regjim dhe sidomos ai i periudhës së kasapit Sllobodan Millosheviç u kanë bërë. Dhe padrejtësia ndaj tyre vazhdoi edhe pas fitores të lirisë dhe pavarësisë që u realizua falë luftës heroike të UÇK - së dhe forcave të NATO - s me SHBA në krye, pasi me një marrëveshje të çuditshme u nda në dy pjesë; atë të Veriut dhe atë të Jugut, ku ura e famshme që i lidhte ato dy pjesë, u bë jo urë bashkimi, por urë ndarjeje. Tani, Ura e Austrelizit ruhet nga patrulla policie si në hyrje ashtu dhe në dalje, dhe kjo situatë aspak e këndshme vazhdon edhe sot e kësaj dite. Pas kaq vitesh dhe me bindjen se hapja e saj u shërben të gjithëve, qeveria e zotit Albin Kurti, vendosi ta lirojë urën nga regjimi policor, ku të mund të kalojnë lirshëm si këmbësorët, ashtu edhe mjetet automobilistike. Në planin qytetar dhe moral, kjo ndarje është e pakuptimtë, kurse në planin ligjor është kufizim i të drejtave dhe detyrimeve që qeveria e Kosovës ka për të ushtruar ndikimin, kompetencat dhe autoritetin e vet në vendosjen e rregullit në atë shtet ku demokratikisht është votuar nga masa e gjerë e popullit. Mirëpo, sa herë ajo kërkon të zbatohen ligjet, si në çdo vend sovran, i dalin tyrli pengesash absurde nga situata politike që në Kosovë është krijuar, pasi aty janë ulur

këmbëkryq ndërkombëtarët të cilët natyrisht kanë planet dhe interesat e tyre. Ndërhyrja e politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare në mënyrë urdhëruese, arrogante e deri kërcënuese është sa e dëmshme aq edhe e papranueshme. Kemi parë se për çdo nismë a veprim që ndërmerr qeveria e Kosovës me kryeministrin Kurti, menjëherë do nxjerrin lloj - lloj yçklash për ta penguar dhe për t'ia prerë hovin, thujse ajo është një marionetë që formalisht qëndron në krye të atij vendi. Për çështjen në fjalë, edhe ambasadori i SHBA zoti Jeff Hovenier nxiton të deklarojë "Shtetet e QUINT - it (Amerika, Franca, Gjermania, Italia, Britania e Madhe. shën. im), në konsultim me NATO - n nuk e përkrahin asnjë ndërrim të statutit të Urës së Ibrit". Pikë e zezë! Them kështu, pasi ata duhej të ishin të parët që ta sheshonin këtë problem dhe jo të ndërsejnë Serbinë e Aleksandar Vuçiçit, duke i rrahur shpatullat atij dhe duke treguar sheshit se ja kanë frikën. Dhe ai e ka zgjuarsinë që të luajë me ta duke i shfrytëzuar këto qëndrime burracake, por aspak në interes të Kosovës. Këtë qëndrim nuk vonon ta shpallë edhe sllovaku Peter Stano, si zëdhënës i Bashkimit Evropian i cili ka marrë përsipër normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit, pavarësisht se më parë është shprehur se nuk synojmë njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe as heqjen e sanksioneve ndaj saj. Oh, komedi! Kanë vendosur të ndëshkojnë popullin e shumëvuajtur të Kosovës, duke harruar se barbaritë e serbëve ndaj tyre nuk janë të kohës së Chinggis Khan - it. Por ai dhe kushdo tjetër, duhet ta dijë se jo zoti i nderuar Peter, por vetë Shën Pjetri të ngarkohet me këtë detyrë, pra për të pajtuar kriminelët serbë me Kosovën, nuk ka për t'ia dalë. Ashtu sikurse nuk do të mund t'i afrojë ata me perëndimin, duke i larguar nga vëllezërit e tyre të gjakut dhe idealit, carët e rinj të Rusisë. Por deri këtu, nuk mund të ndryshojmë gjë, ama vetiu lind pyetja: "Po qëndrimi i qeverisë shqiptare, dhe veçmas i Ministrisë tonë të Punëve të Jashtme cili është?" Nuk kemi parë asnjë deklaratë që ta mbështesë ndërmarrjen e qeverisë motër të Kosovës. Duket se politikanët tanë, si ata të pozitës, ashtu dhe ata të opozitës kanë marrë dylbitë dhe argëtohen duke shuar kureshtjen se si do të vejë kjo punë. Ky është turp! Pse nuk e thonë hapur: Ju aleatë të respektuar që dikur keni dhënë kontributin tuaj të çmuar për Kosovën e lirë, për t'i ndalur dorën gjakatare agresorit, a e dini atë fjalën e urtë të popullit tonë se "Kjo shtëpia me shumë pleq, kujt t'ia prish e kujt t'ia ndreq? Lëreni qeverinë e Kosovës të qetë të bëjë detyrat e saj dhe mos ndërhyri brutalisht me paternalizmin tuaj, se nuk e doni ju atë vend më shumë se vetë kosovarët. Kosova nuk është laborator i eksperimenteve tuaja, sado pragmatiste të jenë ato. Ju vetë, kurrë nuk do të pranoni t'u trajtonin në këtë mënyrë, pasi këtu nuk ka as njerzillëk e as miqësi, por vetëm hilera, nga ato që neve na kanë

shkaktuar prej një shekulli gjyshët tuaj politikanë". Ky duhet të jetë qëndrimi dinjitoz i politikanëve tanë dhe jo strukja e fshehja pas gishtit, sikur nuk po ndodh asgjë në atë pjesë të shtrenjtë të atdheut tonë. Nuk bëjnë mirë edhe ata që me sofizma kërkojnë në emër të këshillimit me ndërkombëtarët, dobësimin e qeverisë Kurti. E kanë gjithë ditën gabim ata që mendojnë se do ta rrezojnë atë qeveri, duke e akuzuar se me qëndrimin e saj "kokëfortë", po krijon situata të papërbalueshme me aleatët. Pra, po i bënka dëm të sotmes dhe të ardhmes së Kosovës, ngaqë mbronka me guxim e trimëri integritetin e atdheut. U dashka të krijohet asociacione serbe, apo duke e lënë të shkëputur Veriun e Mitrovicës që të jetë në rergull. Po sikur, larg qoftë, zoti Kurti dhe qeveria e kryesuar prej tij, t'i pranoni këto lëshime tragjike, a nuk do t'i hidheshin në grykë atij duke e akuzuar për tradhti të lartë? Prandaj, për hir të arvizimit, asnjëherë nuk duhen shpërfillur interesat e mëdha kombëtare. E tha bukur deputeti i Lëvizjes Vetvendosja zoti Dimal Basha: "opozitarët nuk flasin për urën se e dojnë bashkësinë ndërkombëtare më shumë se Kosovën". Ndërkohë Ibri që rrjedh me shkumbëzim e tij të bardhë, teksa sheh se Urën e tij po kërkojnë ta kthejnë në Murin e ri të Berlinit, duket se na përqesh!

A KANË PUNË TJETËR KËTA NDËRKOMBËTARËT?

As ura e varur e Bruklinit, gati dy km. e gjatë, e ndërtuar për 14 vjet me radhë nga Emily Roebing, gruaja e ideatorit gjerman John, që me historinë e saj plot viktima dhe madhështinë inxhinierike, u bë një nga simbolet më të rëndësishme të Nju Jorkut, nuk ka tërhequr qysh nga viti 1883, kaq shumë vëmendjen e diplomacisë botërore, sa ajo ura e thjeshtë me dy harqe si veshë e Ibrit, që ndan në dy pjesë qytetin shqiptar të Mitrovicës në Kosovë. Sot, në kohën kur luftat e përgjakshme në Ukrainë dhe Palestinë po marrin prej një kohe të gjatë mijra e mijra jetë njerëz, ku nuk kursehen as fëmijët e shkollave, sot pra kur bombardimet e topave dhe raketat po shkatërrojnë deri në rrafshim qytetërimi të tëra, duke shkaktuar tragjedi të tmerrshme, që nuk po u duket fundi, e gjithë vëmendja e ndërkombëtarëve duket se është përqendruar tek ajo ura e menaxhuar dikur nga francezi Pierre Lottici, dhe që kushtoi gjithsej vetëm 3 milion marka. Urat kudo në botë ndërtohen për bashkim, kurse muret për ndarje. Atëherë, përse kërcyen përpjetë të huajt dhe nisën nga parajmërimet e kërcënimit, sapo dëgjuan se Kryeministri i Kosovës, zoti Albin Kurti ka vendosur që ajo urë, e cila brenda shtetit të Kosovës po shërbente si vijë demarkacioni mes shqiptarëve dhe serbëve, tani e tutje të hapej dhe të bëhej e kalueshme për të gjithë qytetarët dhe mjetet e tyre, pra të kthehej në qëllimin për të cilin ishte ndërtuar.



REFLEKSIONE

NGËRÇI NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Nga Bashkim Hisari

Muajin e kaluar, në Paris, përfunduan Lojërat Olimpikë. Ndoqëm një spektakël për historinë, të cilin bota nuk e ka parë. Parisi ishte skena ku u zhvilluan garat e sportistëve nga të gjitha kontinentet. Në ceremoninë e hapjes, nëntë sportistë kosovarë, valëvitën flamurin e Republikës së Kosovës (pa fusnotë) dhe arritën të fitojnë dy medalje olimpikë: Distrie Krasniqi medaljen e argjent dhe Laura Fazliu të bronzit. Lojërat olimpikë u ndoqën nga qindra mijëra spektatorë dhe nga miliarda njerëz pranë ekraneve televizive në mbarë botën. Ishte një thirrje për mirëkuptim, respekt për diversitetin dhe barazinë gjinore, një odë për dashurinë, paqen dhe kundër dhunës.

Lojërat u ndoqën me interesim edhe në Kosovë por nuk u lanë në harresë ngjarjet festive. Korriku dhe gushti anembanë Kosovës janë bërë tradicionalisht muaj të shënuar të kremtimeve, dasmave, takimeve të mërgimtarëve në vendlindje. Në sallone për ceremoni të dasmave, nëpër kafiteri e sheshe ku organizohen mbremje të hareshme me muzikë popullore, folklorike, moderne, deri në atë klasike, dhimbja, krenaria dhe nostalgjia e njerëzve përziheshin me patriotizmin. Qytetarët shprehnin shqetësime për tensione në veri të vendit dhe për zhvillimet e mëtejme në raport me Serbinë. Top tema në debate të gjera, të ashpëra e të hapura ishin çështjet aktuale, shqetësimet për mundësinë e përkeqësimit të situatës së sigurisë, rreziku që Serbia të përsërisë Banjaskën me grupe ekstremiste që po përgaditen në kufi me Kosovën. Veçori të dallueshme ishin mendimet dhe pikëpamjet për ecuritë në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga BE, për fatin e të zhdukurëve me dhunë, hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë e cila një kohë të gjatë është bllokuar me rëre dhe fortina betoni nga serbët dhe shërben si vijë ndarëse në mes veriut dhe jugut, për mbylljen e degeve ilegale të Postës së Serbisë në veri të vendit etj.

Njëkohsisht, me argumente bindëse qytetarët trajtonin krimet gjatë luftës 1998-99 në Kosovë. Kërkonin përgjegjësi për shumë masakra që janë kryer dhe zbulimin e varrezave masive të cilat trashigimtarët dhe baskëpunorët e kriminelit Sllobodan Millosheviq që tani janë politikanë në pushtetin serb i mbajnë të fshehura. Autoriteve të Kosovës, qytetarët u bënë thirrje që t'iu japin fund përplasjeve, t'iu këthehen angazhimeve konstruktive dhe ti bashkëkoordinojnë veprime me ndërkombëtarët për t'iu zgjidhur çështjet që i përkasin procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë që do të rezultonte me arritjen e një marrëveshjeje ligjrisht të obligueshme për normalizim dhe me njohje reciproke mes dy shteteve.

Por, në një kohë të parashikueshme, a mund të tejkalohet ngërçi dhe efektet negative dhe çfarë janë gjasat të përmirësohen marrëdhëniet politike dhe ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë ?

Zgjidhja kërkon shumë punë e kujdes dhe pa ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, situata vështirë mund të normalizohet. Jeta do vazhdojë të jetë e "ngjirë". Rrënjët e së keqes serbe, janë të thella. Historia e Serbisë ka pasur me dekada disa veçori në zbatimin e një politike të urrejtjes të paarsueshme të qëllimë për të ushtruar dhunën më të egër për shfarosjen e plotë të shqiptarëve. Shumë veprime të tyre kanë qenë të ngjashme me ato që i përafrohen nazi-fashizmit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët e Kosovë mendonin se më në fund u çliruan, ata u mashtruan, u ballafaquan me shumë forma të diktaturës, shtypjes, dhunës, persekutimeve, përndjekjeve politike deri në konflikte të armatosur dhe krime ç'njerëzore me elemente gjenocidi. Nuk u

zbatuan vendimet e Konferencës së Bujanit. Ato u mohuan, u sulmuan, nuk u mbrojtën, nuk u respektua vullneti i fortë i popullit kosovar për vetëvendosje dhe bashkimi me shtetin amë Shqipërinë.

Në vitet 1948-1968, gjatë kohës së Rankoviqit, vazhdoi realizimi i planeve dhe programeve serbomëdha. U riaktualizua projekti antishqiptar i Çubrilloviqit për asgjësimin, asimilimin dhe shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike.

Në vitet 1998-1999, kriminelët e regjimit të Millosheviqit kryen krime më të tmerrshme dhe më barbare. Shkatrruan qytete dhe fshatra. Vranë gra, fëmijë dhe burra, civilë të pafajshëm. U dhunuan seksualisht gratë shqiptare. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, 1613 persona janë të zhdukur në Kosovë. Pas këtyre numrave dhe statistikave janë jetët, dëshirat, shpresat e ëndrrat e familjarëve. Të pagjeturit janë shkëputur me dhunë nga përfaqimi i njerëzve të tyre të cilët vuajnë vetëm në heshtje dhe dhimbje. Të dashurit e tyre nuk kanë varre, një vend ku mund të vendoset lule, familjarët të luten dhe të dinë se ata kanë gjetur paqen e fundit. Regjimi në Beograd e dinë se ku janë trupa e viktimave, por heshtet më shumë se dy dekada, dhe ndonjëherë heshtja është më e keqe se çdo veprim. Institucionet shtetërore në Serbi vazhdojnë të fshehin faktet për krimet e luftës kundër shqiptarëve të Kosovës dhe po rehabilitojnë e madhërojnë kriminelët e dënuar për krime lufte. Pak njerëz në Serbi dinë për më shumë se 13 mijë të vrarët, për rreth 400 masakra, për krimet ndaj Jasharajve, për masakrën në fshatin Meje afër Gjakovës ku forcat serbe vranë të paktën 377 civilë shqiptarë, apo për masakrën në Suharekë ku u ekzekutuan 48 anëtarët e familjes Berisha etj. Pa të vërtetën për këto krime serbe dhe pa ballafaqim me të kaluarën nuk ka ardhmëri në marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve.

Hapi i parë kyç dhe simbolik në arritjen e një kompromisi, përmirësimit të marrëdhënieve, arritjes së marrëveshjes dhe paqes, është pranimi i krimeve serbe ndaj shqiptarëve. Kjo do ishte normale, njerëzore dhe shumë e thjeshtë. Por, shumica e serbëve ende nuk janë të gatshëm të njohin dhimbjen e të tjerëve para së gjithash si dhimbje njerëzore,

të kuptojnë gjithçka që kanë përjetuar shqiptarët dhe çfarë kanë bërë me dekada ndaj tyre. Pranimi i poshtrimit, pendimi dhe kërkim falje do ishin gjestet simbolike dhe hapi i madh përpara për arritjen e paqes por që nuk nënkupton të harrohen krimet e tmerrshme. Se aktet dhe veprimet e tilla luajnë rol të madh le të kujtojmë Vili Brantini i cili u ul në gjunj para Hollokaustit dhe në emër të Gjermanisë kërkoi falje për krimet që kanë bërë nazi-fashistët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas më shumë se njëqind vite Gjermania pranoi edhe krimet e kryera nga forcat e tyre koloniale në Afrikë Luftëtar i lirisë, Nobelisti Nelson Mandela i cili luftonte kundër shtypjes racore në burgun e Afrikës së Jugut, mësoi gjuhën afrikane dhe studioi kulturën e grupit etnik të bardhë që kishte organizuar aparteidin. Hyri në negociata me gjeneralin afrikan Fillon, dhe bisedoi me të, në gjuhën e tij. Ishte gjesti i respektit të vërtetë të Mandelës për kulturën dhe vlerat e shenjta afrikane dhe ndihmoi ti jepet fund aparteidit. Kur Mandela vdiq, Fillon mbajti një fjalim në gjuhën amtare të Mandelës.

Bisedimet në Bruksel janë në ngërç. Dijalogu mes Kosovës dhe Serbisë është i "vdekur". Në

vend të bisedohet në mënyrë racionale, atje debatohet për konfliktet e supozuara të pazgjidhshme. Pala serbe nuk po tregon gatishmëri për bisedime të sinqerta. Regjimi aktual serb në krye me Vuçiqin që ishte ministër i propagandës në pushtetin e kriminelit të luftës Millosheviq dhe pasardhës i kryeqendrit Sheshel i dënuar për krime lufte, me retorikën luftënxitëse vazhdon të krijon tensione. Politika e normalizimit të marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë nuk ka alternativë, por Beogradi ende nuk po heqë dorë nga paragjykimet, nga qëllimi i dominimit mbi popullin shqiptarë dhe mbi Kosovën, nga kërkesa që shqiptarët të jetojnë nën kontrollin dhe juridikcionin serb.

Shqiptarët tani më kanë realizuar shumicën e qellimeve reale, të drejta, politike dhe kombëtare. Janë të përcaktuar të forcojnë shtetin demokratik dhe të jetojnë në paqe duke evituar çdo konflikt të mundshëm e tensionet politike dhe aspiratë e tyre është sa më shpejtë të integrohen në strukturat euro-atlantike.



80 VJETORI

Rruga e lavdishme e Brigadave të 20-të, 22-të dhe 23 Sulmuese Partizane

Më 9 shtator, veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre do të jenë shpirtërisht në Protopapë, Maliq, Korçë, Pogradec, Elbasan, Librazhd, Zvezdë, Qafë-Thanë, Përrenjas, Domozdovë, në grykat e Xhyrës dhe kudo ku kanë luftuar e fituar partizanët e Brigadës XX Sulmuese.

Brigada XX u formua në Protopapë, më 9 shtator 1944, prej bashkimit të batalionit të famshëm "Tomorri", me batalionet e tjera që vepronin në këto krahina, si "Reshit Çollaku", "Hakmarrja", "Fuat Babani" dhe "Skënder Çaçi".

Asaj iu bashkuan qindra vajza e djem të rinj nga Korça, Skrapari dhe Elbasani, të cilët formuan sëbashku këtë formacion partizan, të njohur për vitalitetin, trimërinë dhe heroizmin e pashoq. 1200 partizanët e Brigadës XX, siç shkruan historia e Luftës, nuk kanë në bilancin e tyre asnjë betejë të humbur. Vetëm një ditë pas krijimit, më 10 nëntor 1944, partizanët e Brigadës XX hynë në Librazhdin e çliruar dhe një javë më vonë, më 17 nëntor, në Elbasanin e çliruar. Populli i Elbasanit, Librazhdit dhe gjithë krahinave të tyre do t'u jetë mirënjohës përjetë vajzave e djemve të kësaj brigade, të cilët i çliruan ato nga okupatori nazi-fashist dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas.

Brigada XX ishte pjesë e uraganit të fuqishëm të Ushtrisë Nacionale

Brigada e XX-të, pjesë e uraganit të fuqishëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Vlerat antifashiste nuk vjetërohen kurrë. Ato qëndrojnë në themel të lirisë, të përparimit, të kontributit tonë në NATO, për paqen, sigurinë e stabilitetin në rajon e në botë, në themel të rrugëtimit europian të Shqipërisë

çlirimtare, e cila çliroi Shqipërinë nga pushtuesit nazi-fashistë dhe tradhëtarët vendas.

Ushtria e partizanëve shqiptarë luftoi denjësisht në krah të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ushtrisë së Kuqe, Ushtrisë së Britanisë së Madhe, të Francës dhe vendeve të tjera të koalicionit antifashist. Ishin partizanët shqiptarë, këta kalorës të çlirimit e të lirisë, që e vendosën Shqipërinë në anën e drejtë të historisë, në krah të forcave antifashiste e çlirimtare. 9 shtatori, është dita të kujtojmë se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe vlerat antifashiste nuk vjetërohen kurrë. Ato qëndrojnë në themel të lirisë, të përparimit, të kontributit tonë në NATO, për paqen, sigurinë e stabilitetin në rajon e në botë, në themel të rrugëtimit europian të Shqipërisë.

**Brigada e 22-të Sulmuese dhe luftimet nga Peza në Vishegrad**

Kujtojmë në këtë 80 vjetor të krijimit të saj ish komisarit e saj, të paharruarin Nimet Ymeri, i cili na ka lënë pas, si një testament të vyer librin e tij "Nga Peza në Vishegrad"

Më urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSh, më 18 shtator 1944, në Pezën heroike të komandantit legjendar Myslim Peza, u krijua Brigada 22 Sulmuese partizane e ushtrisë shqiptare. Aty të sheshi i gjelbëruar para shtëpisë së komandantit të Çetës së parë antifashiste në Shqipëri e Europë, Babë Myslimi, ishin të rreshtuar në formacion të rregullt, të ndarë në batalione e kompani, 1127 partizanë.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti trim Myslim Peza, përfaqësuesja e Komitetit Qendror të PK Naxhije Duma, përfaqësuesi i ShP të UNÇSh, Kristo Themelko, i cili edhe përshëndeti me këtë rast. Për drejtimin e Brigadës 22 Sulmuese, u caktuan: Komandant i Brigadës, komunisti Sali Verdha. Zëvendëskomandant i Brigadës Shaban Rexha. Komisar i Brigadës, komunisti Tonin Jakova. Zëvendëskomandant i Brigadës, Sadik Bocaj. Komandant i batalionit të parë, Muharrem Kokomani (i cili pas disa ditësh caktohet komandant i Brigadës 23 Sulmuese partizane). Komisar i batalionit të parë komunisti Shim Kolli. Komandant i batalionit të dytë, Sotir Spiro. Komisar i batalionit të dytë, Xhevdet Petrela. Komandant i batalionit të tretë, Ymer Hoxha. Komisar i batalionit të tretë, komunisti Hysen Ballhysa. Komandant i batalionit të katërt

u caktua komunisti Nimet Ymeri, i cili në nëntor 1944 caktohet komisar i brigadës 22 Sulmuese, deri në 15 dhjetor 1945. Sadik Bocaj u caktua drejtues i organizatës së partisë të Brigadës 22 S, e cila kishte 75 anëtarë të PK. Iliaz Reka u caktua drejtues i Rinisë të Brigadës 22 Sulmuese.

Për rreth 20 ditë Brigada e 22 Sulmuese zhvilloi luftime në zonën e Tiranës, Kavajës, Peqinit, Durrësit, Shijakut për eliminimin e elementëve kriminalë të Ballit Kombëtar, për forcimin e pushtetit të ri të këshillave nacional-Çlirimtare dhe dorëzimin e pushtetit, komandave të vendit.

Me datën 6 e 7 tetor 1944, Brigada e 22 Sulmuese ishte pozicionuar në fshatin Gropje të Tiranës nga ku mori urdhërin luftarak për marshim për në veri të Shqipërisë, duke kaluar në zonën e malësisë së Krujës, me luftime të ashpra çliron Shpalin, kryeqendrën e bajraktarëve të Mirditës, shpartalloi forcat e reaksionit të Gjon Markagjonit, dhe të Kol Bibë Mirakës. Luftime të ashpra u zhvilluan në Fan, Gëziq, Gjegjan, Kryezi, ku ra heroikisht pionieri 14 vjeçar Met Hasa, partizani Rexhep Kodra (Fortuzi), si dhe u plagosën partizanët Fatime Pullazi, Sherbet Karuli, Shkurt Pajona, Etem Kalaja, Zydi Mustafa, Haxhi Grori, Asllan Istrefi, Stavri Goreja. Luftime të ashpra u zhvilluan gjatë muajit nëntor 1944, në zonën e

Mirditës e të Pukës, dhe më 21 nëntor Puka çlirohet. Pas kësaj, Brigada e 22 S, nisjet drejt Shkodrës, ku ishin përqëndruar edhe brigadat e 6-të dhe e 7-të.

Me luftime të ashpra në datat 26-27-28 nëntor dhe në mëngjezin e datës 29 Nëntor 1944 Shkodra dhe e gjithë Shqipëria ishte e çliruar plotësisht nga pushtuesi nazistë gjermanë.

Në orën 10.00 paraditen e 29 Nëntorit në Shkodrën e çliruar ngrihet flamuri i lirisë, ku zëvendëskomisari i batalionit Irfan Çelkupa mban një fjalim emocionues para popullit shkodran e partizanëve.

Pas 3-4 ditësh pushimi në Shkodër, Brigada e 22 Sulmuese, nisjet me urdhër të komandës e ShP, për të kaluar kufijtë shtetërorë në ndihmë të popujve të Malit të Zi dhe Bosnjes.

Me luftime të ashpra forcat partizane kalojnë kufirin shtetëror, dhe në Deçiq bien heroikisht partizanët trima dëshmorë të atdheut Xhemal Zanalui, Demir Milaqi, Rahman Myrta, mitralieri trim Qazim Alimehmeti, dhe më 6 dhjetor 1944 u çlirua qyteti i Tuzit. Në këto luftime ranë në fushën e betejës shumë partizanë dhe gjermanët pësuan humbje të rënda. Pas çlirimit të Podgoricës brigada e 22 S, nisjet për luftime drejt Bosnjes jugore në mes të një dimri të egër, me dëborë, dhe acar.

Nga 31 dhjetor '44 deri më 5 janar

1945 arrijnë në afërsi të Suhagorës; çlirojnë Goleshin dhe Plavien, dhe pas pak ditësh çlirojnë Vishegradin. Ranë heroikisht 12 partizanë, Zyber Jancari, Naum Shamia, Ramazan Ismil Gjuzi, Ramazan Dervish Habili, Thoma Koli Filipi, Haxhi Selim Maloku, Ibrahim Myrteza Brahja, Ferhat Haxhi Berberi, Riza Pëllumb Leshteni, Sulejman Rexhep Rexha, Nebi Ramazan Hoxha, Rustem Ibrahim Dervishi.

Me çlirimin e Vishegradit, Brigada e 22 S, kthehet për në Kosovë dhe më 12 mars '45 arrijnë në Mitrovicë. Me 3 mars përqëndrohet në qytetin e Vuçiternit. Më 4 prill '45 bëhet ceremonia e varrimit e Rexhep Zunës, komandant i brigadës 22 S, i cili vdiq në spitalin e Mitrovicës dhe Neshat Hysi caktohet komandant i brigadës. Për aq sa ishte në Kosovë brigada ndihmoi në stabilizimin e situatës atje.

Në ditët e para të qershorit 1945 brigada kaloi në tokat shqiptare të Maqedonisë në ndihmë të këtyre krahinave dhe për pastrimin e bandave kriminale të Adem Ali Basharit, Gjon Markagjonit e Pashuk Bibës. Më 7 dhjetor '45 mbërrin në Elbasan e përqëndrohet në kazermat e Krastës. Këtu përfundoi misioni i saj heroik. Nga efektivit prej 1400 partizanësh, dhanë jetën 107 partizanë. Brigada përshkroi një rrugë prej 3500 kilometrash. Kujtojmë mes të tjerash në këtë rast ish komisarit e saj të paharruarin Nimet Ymeri, i cili na ka lënë pas, si një testament të vyer librin e tij "Nga Peza në Vishegrad".

80 VJETORI

Perkulemi me respekt të thellë përpara 21 dëshmorëve të kësaj brigade dhe familjeve të tyre

Lavdi 21 dëshmorëve të Brigada XXIII Sulmuese

80 vjet më parë, më 21 shtator 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, në Zall-Mener, u krijua Brigada e 23 Sulmuese Partizane. Kjo brigadë u formua nga batalionet partizane "Dajtit", "Krujë -Ishëm" dhe "Mat" te cilët kishin në efektiv të tyre partizanë me pervojë, të kalitur në aksione luftarake kundra nazifashizmit italo - gjerman si dhe tradhtarëve të vendit, që kishin kaluar prova të rënda, sakrificash në lufte, sidomos gjatë Operacionit të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Drejtuesit e Shtabit të Brigades ishin: Komandante- Hamit Keçi, Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani; Komisarë politikë- Xhavit Qesja, Mërkur Çela; zv/komandant Haki Fejzo, zv/komisar Sejdin Avdia.

Sapo u formua brigada me drejtuesit e saj, u ngarkua me detyren luftarake që të merrnin pjesë në lufte për Çlirimin e Tiranës, Krujës, Vorës, Fushë- Krujës, Prezes, Milotit, Pukës, Mirditës, Matit, Lezhës e deri në Shkodër. Ngarkoheshin të goditnin përqëndrimet armike të vendosura në ato zona dhe do të shkatërronte forcat mercenare, si ato zogisto - balliste, të cilët ishin pro e bashkëpunonin me pushtuesit nazifashistë të perqendruara në kalatë e Krujes, Prezes e Ishmit. Luftrat e Brigadës së 23-te sulmuese ishin shumë të suksesshme mbasi pati mbeshitetjen e fortë nga këshillat ANÇ, familjet që i kishin kthyer shtepite baze lufte dhe mbare populli i ketyre zonave. Luftrat u bene nga nje zone në tjetren dhe arriten deri në Shkoder.

Në mëngjesin e 29 nentorit 1944 forcat e kesaj brigade pas një lufte të ashpër për çlirimin e Shkodres, duke iu bashkuar forcave të brigadave 6-te, 7, 22 dhe 24-t dhe grupeve partizane të atij qyteti - të gjithë bashkë, pasi shporrën pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga Shodra, u grumbulluan përpara Prefektures ku u mbajt ceremonia festive dhe u dha lajmi që Shkodra u çlirua. Çlirimi i Shkodres shenonte edhe çlirimin e gjithë Shqipërisë nga pushtuesit nazifashiste.

Kjo që nje ngjarje me rendesi të madhe historike dhe u përhap në të gjithë vendin.

Në këtë 80 vjetor, duke perkujtuar rrugën e lavdishme luftarake të Brigades 23-te Sulmuese, u shprehim mirenjohje të gjithë atyre partizanëve që bënë pjesë në këtë brigadë dhe të gjithë familjeve të tyre dhe shtëpive baze të LANC, si dhe Keshillave Antifashiste. Perkulemi me respekt të thellë përpara 21 dëshmorëve të kësaj brigade dhe familjeve të tyre.

shkon për ne Qafshatame, për të perjetuar formimin e Brigades 23 S, luftën e saj heroike kundër armiqve si dhe dëshmorët e saj, është ngritur lapidari ku janë skalitur emrat e të gjithë dëshmoreve të saj si me poshtë:

1. Abaz Veseli
2. Adem Gjeli
3. Ali Metra
4. Avdi Kazani
5. Riza Beka
6. Bakushe Visha
7. Besim Beja
8. Gani Guxhiqi
9. Islam Shehi
10. Luigj Kurti
11. Njazi Meka
12. Llesh Spaçi
13. Mustafa Dervishi
14. Mustafa Mezini
15. Ibrahim Liçi
16. Ramazan Zambaku
17. Rexhep Shira
18. Shaban Lika
19. Turabi Dura
20. Vath Bushi
21. Vesel Brama



FERIDE KURTI VETERANIA E KËNGËS MATJANE

(vijon nga faqja 9)

pozimet e tyre duke e zgjedhur si këngëtare që arrinte të realizonte më bukur krijimet. Sukseset e ansambli "Mat" në festivalet folklorike kombëtare janë të lidhura edhe me emrin e aktivitetin e saj artistik, ndërsa repertori i këngëve të saj është në fondin e artit të Radio Tiranës, Radio Prishtinës, të Radio Kukësit, Radio Korçës e Radio Gjirokastrës.

Nuk është e rastit as fakt i panjohur që ajo është cilësuar "Princeshë e këngës matjane", një cilësim i merituar për këtë artiste aq të dashur. Ajo ishte një artiste që e këndonte këngën duke bërë një punë profesionale me të, që dinte ta interpretonte mjeshtërisht dhe natyrshëm.

Kujtimet për të nuk kanë mbarim nga artistë dhe ata që e kanë njohur këtë këngëtare zë-bilbil. Kolë Ndreka e Ymer Neli (Artist i Merituar e Mjeshtër i Madh) flasin me nderim për të, nderim që ajo e mori sa ishte në jetë nga një publik anë e kënd trojeve shqiptare.

Kënga e saj përcjell fladin e Luginës së Matit, rrjedhën e lumit Mat, epikën e malit të Dejës, kohën që jetoi dhe kohërat, me tekste të thjeshta e të bukura, me meloditë gurgulluese duke emocionuar artdashësit dhe duke shtuar një perlë në gjerdanin e artit të popullit e të artit të këngës me nivel profesional. Si mbesë e Kadiut në fshatin Fshat të Klosit, si një cucë matjane e rritur në hapësirën e lirisë të kësaj natyre të bukur, zëri i saj u bë mishërim i asaj çka kishte më të bukur kjo natyrë.

KËNGA E FERIDE KURTIT NUK VDES KURRË

Kënga e Feride Kurtit nuk vdes kurrë. Ajo erdhi në tribunën e këngës, kur për këngën shqiptarët kishin shumë uri. Ishte vajza e parë matjane, që merrte atë guxim. Kishte ambicien, që në tempullin e këngës të barazohej me burrat, për të dëshmuar bukurinë dhe fuqinë e zërit të femrës, që njëherësh përfaqëson nënën, motrën, gruan, shqiptaren. Shpërtheu shpirti i saj, zëri që gjer atëherë na kishte munguar. Paralajmëronte ai zë mbërritjen e këngëtares që do ta bënte më të njohur Matin në gjithë Shqipërinë e do të çonte në këmbë qindra e mijëra njerëz në Kalanë e Gjirokastrës, në Pallatin e Kulturës të kryeqytetit, në fshatra e qytete, anëmbanë vendit. Një mal me këngë për luftërat e lirisë, një gjerdan me këngë lirike matjane, që janë të rralla për meloditë dhe vargjet e ndjera, pruri e përcollti viteve Feride Kurti.

Ajo na bëri më të bindur se në jetën tonë kënga lirike ka vendin e pazëvendësueshëm, që na afron më shumë me sofrën, me të bukurën, me dashurinë, me lirinë e vetvetes. "Çaheshin" radiot kur këndonte Feride Kurti këngën "Cucë e bukur moj matjane", "A e mban mend e vogëlo", "Valëzat e Liqenit", "Ndalu mbret se k'tu s'asht Roma" dhe mbi 60 këngë të tjera që ruhen në fondin e artit të Radio Tiranës dhe TVSH-së. Jeta për Feride Kurtin ishte kënga. Ndryshe ajo nuk do të bëhej aq e kërkuar në katër anët e vendit, madje edhe jashtë atdheut. Do të vinte një ekip nga Radio Televizioni i Prishtinës, të qëndronte disa ditë në Burrel për të regjistruar këngën e Feride Kurtit kushtuar Heroit të Popullit Vasil Laçi dhe disa këngë

të tjera folklorike. Ferideja sakrifikoje për këngën, jo në emër të emrit të saj, por për të përfaqësuar Matin në aktivitetet e rëndësishme kombëtare.

FERIDE KURTI MBETET NJË NGA PERLAT E KËNGËS POPULLORE TË MATIT

Feride Kurti i përket plejadës së këngëtarëve, të cilët me këngët e bukura të tyre, plot kuptim e jetë i bënë shqiptarët ta donin jetën dhe të shpresonin për ditë më të mira. Shumica e rinisë shqiptare e asaj të Kosovës e asaj kohe u rriten me këngët e kësaj plejade, të cilat ishin plot gjallëri e jetë. Këngët e kësaj plejade e ishin himne për ne. Feridja, me zërin e saj brilant bëri për vete dëgjues të të gjitha krahinave shqiptare, në jug e në veri.

Feride Kurti mbetet një nga perlat e këngës popullore të Matit.

Artisti i madh, matjan, Ymer Neli, në kujtimet e tij, për Feriden thotë:

* 1968 Hera e parë që festivali folklorik kombëtar zhvillohej në Gjirokastrë. Këtu Ferideja u paraqit me "Këngë kushtuar Shkurte Skurës", krijim i Sabri Alisë.

* Një nga ato ditë të festivalit në shkuan në qytetin e Delvinës për të dhënë një shfaqje. Lokali ku ne jepnim shfaqjen ishte mbushur plot. Në momentin kur filloi të këndoje Ferideja, ata që ishin jashtë thyen xhamat duke u futur nga dritaret për të parë nga afër Feriden kur këndonte. Në orët e vona të natës na shpuan gomata e autobuzit që të mos largoheshim nga Delvina.

Kjo ishte Feridja ... zëri i saj brilant pëlqej gjithandëj në trojet shqiptare...

21 DËSHMORËT E BRIGADËS XIII S

Ne Krujë, te kthesa e rrugës që

SUPLEMENTI LETRAT

Kontributi i studjuesit të mirënjohur Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Pukës në ndriçimin e historisë së një prej luftërave më heroike

"Na ka çue Shkodra ni fjalë"

Fakte të reja për Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbo-malazeze (Nëntor 1912 - maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

"Na ka çue Shkodra ni fjalë", libri i ri, i sapobotuar i studjuesit Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Pukës, është një botim interesant me përmbledhje artikujsh, kryesisht për Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbo-malazeze (Nëntor 1912 - maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar.

Autori i këtij libri ka meritën se për herë të parë sjell referenca të shumta nga autorë vendas e të huaj për qëndresën e shqiptarëve për mbrojtjen e Shkodrës që përbën epopenë më heroike e më madhështore në historinë e luftërave të shqiptarëve. Kështu, nëse në shënimet e Mareshalli turk Mustafa Fevzi Çakmak, pjesëtar i shtatmadhorisë së armatës turke për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës, ndër të tjera shkruhet që "Mbrojtja e Shkodrës të merret si shembull krenarie kombëtare!", Xh.Meçi sjell edhe referencën e Gino Berri, korespondent italian i luftës, i cili shkruan se "Luftën e bënin ata (shqiptarët), që sapo kishin shpallur Pavarësinë e Atdeut, agimin e ri të vendit të tyre.

PAK NGA HISTORIA

Në artikullin "110 - vjetori i Luftës së Shkodrës kundër ushtrive pushtuese serbo-malazeze gjatë rrethimit barbar 7 mujor, nëntor 1912-prill-maj 1913", Xhemal Meçi sjell fakte dhe ngjarje që flasin për qëndresën heroike të shqiptarëve kundër pushtuesve barbarë. Ndër të tjera ai shkruan: "Forca vullnetare të ardhura që nga Kavaja, Tirana, Kruja, Dibra, Lura e Mati numëroreshin deri në 4000 luftëtarë, të komanduara nga Esat Pasha. Ushtria Malazeze bombaronte pa reshtur. Edhe sulmet e ushtrisë tokësore ishin të furishme drejt pozicioneve të mbrojtjes së Shkodrës. Në mënyrë të herëpashërshme, çdo

ditë, sulmonte edhe ushtria serbe nga fronti i lindjes dhe i jugut, por pa sukses. Humbjet e tyre ishin të shumta. Mbas lufte Mali i Zi i Krajl Nikollës deklaronte se për mposhtjen e Shkodrës ka pasë më se 8000 luftëtarë të rënë. Prandaj Urrejtjen për këto humbje e shfryenin duke bombarduar qytetin, sidomos lagjet myslimane. Megjithatë Shkodra nuk jepej. Por pak nga pak armiku kryesor i saj u bë uria, jo vetëm për qytetarët, por edhe për luftëtarët. Mbas 5 muajsh rrethimi e lufte, u mbaruan të gjitha rezervat ushqimore, aq sa nga fillimi i marsit 1913 u mbyllën të gjitha furrat e bukës, nga që ishte sosur mielli. Kështu uria u bë masive me pasoja sëmundjesh e vdekjesh. Nga fillimi i prillit mesatarja e të vdekurve arriti në 25 vetë në ditë. Një ditë prej ditësh u gjetë e vdekur një nënë me tre vocrrakët e saj rrotull qafës. Edhe ata të vdekur urie; Një burrë kah se nuk i shihte dot dy djemtë e tij vocrrakë duke u përplitur nga uria e vdekjes, se kishin 10 ditë pa ngrënë, hoqi koburën dhe i vrau (kurse vet u zhduk!!!). Edhe në ushtri gjendja që po aq e rëndë, se u arrit që të ndaheshin vetëm 400 gram peksimet në ditë, po edhe ato me kryma. Në vazhdim ranë në 200 e 100 gram. Kështu, luftëtarët shtriheshin në pozicione gjysëm të vdekur!! Ndërsa Fuqitë e Mëdha, të mbledhura në Londër u kujtuan së fundi, nën presionin e Austro-Hungarisë vetëm më 22 mars 1913, se duhej të ndërhynin ushtarakisht, si paralajmërim për Cetinën kokëfortë, se ia njihnin Shkodrën me rrethinë Shqipërisë, duke u kërkuar që të hiqnin rrethimin e Shkodrës. Më 12 prill 1913 u tërhoq ushtria Serbe, kurse ajo malazeze jo. Atëhere Fuqitë e Mëdha urdhëruan për një presion force... Kështu që në fillim të prillit një skuadrilje detare ndërkombëtare, nën komandën e nënadmiraletit anglez Sesël Bërnei bllokoi Tivarin deri në grykën e Drinit. Por ushtria malazeze, rifilloi sulmet, sapo skuadrilja detare u largua. Gjendja e të rrethuarve u bë si edhe më parë e padurueshme. Më 14 maj 1913, hynë forcat e skuadriljes detare ndërkombëtare, kurse administrimin e qytetit e mori një komision ndërkombëtar i kryesuar nga anglezi Sesil Bërnej, i cili nuk lejoi festimin e Bajramit, as ngritjen e Flamurit kombëtar shqiptar në Shkodrën e shkretuar. Për më tepër, nuk përfilli as Qeverinë e Vlorës, e cila ishte e vetmja qeveri legjitime e Shtetit Shqiptar (me Shkodër) (!!!)" (fq. 12-14).

Po në këtë artikull Xh.Meçi sjell



referencën e Dr. Dutton, profesor në Universitetin të Kolumbisë, sipas të cilit "Raporti i Komisionit Ndërkombëtar ishte një dokument tragjik, ndërsa dy luftërat ballkanike - si kapituj vdekjeje dhe tmerri, se viktimat më fatkeqe e më tragjike në masakrën e Ballkanit ishin Shqiptarët".

Duke patur si pikë referimi Prof. dr. Bajram. Xhafën që është edhe redaktor i librit, autori i këtij libri, që në hyrje na njeh edhe me frontet e mbrojtjes së Shkodrës. "Hasan Riza Pasha, Komandanti i Përgjithshëm i forcave mbrojtëse të Shkodrës me rrethinë, që pa fillue Lufta e Parë Ballkanike mori masa mbrojtëse, me punimet për fortifikime të menjëherëshme, duke përcaktuar dy vija mbrojtëse: Vija e parë mbrojtëse, nga kështjella dhe kodrat në lindje të kalasë. Vija e dytë mbrojtëse ishte më e jashtme, e përbërë nga fortifikimet e Taraboshit, kodrat e Bërdicës, Beltojës, Vukatanës e Bardhajve. Në pozicione u vendosën 25 mijë forca luftarake me gryka zjarri artilerie të futura thellë në tokë mbi lartësitë e kodrinave. Kështu Shkodra mbrohej nga katër pikëmbështetje, që përbënin katër frontet kryesore: 1. Në veri, - Fronti i Shtojt, pjesa mes Liqenit dhe lumit të Kirit; 2. Në lindje, pjesa mes Kirit e Drinit, - Fronti i Bardhanjorit; 3. Në jug, pjesa në mes të Bunës e Drinit - Fronti Bërdicës; 4. Në perëndim, zona prej Bunës e Liqenit deri te mali Taraboshit, - Fronti i Taraboshit".

KUSH ISHTE KOMANDANTI I GARNIZONIT USHTARAK TË SHKODRËS HASAN RIZA PASHA

Për herë të parë në këtë libër (botim i "FIORENTIA", Shkodër 2024)

gejmë edhe në një portret Hasan Riza Pashës (1871-1913) - Vali dhe komandant i garnizonit ushtarak të Shkodrës. A

i kishte lindur në Bagdat nga një nënë me origjinë shqiptare. Studimet ushtarake i kreu në Stamboll dhe i plotësoi në Akademinë e Luftës në Berlin (1899 - 1903). Shërbeu në detyra të larta ushtarake në Janinë dhe në Manastir.

Në janar 1911 caktohet komandant i korpusit Ushtarak (Garnizonit) Shkodër. Mars 1912 u emërua edhe Vali i Vilajetit Shkodër. Organizoi e drejtoi me vendosmëri e guxim gjatë rrethimit të plotë nga ushtritë pushtuese serbo - malazeze mbrojtjen e qytetit të Shkodrës me një efektiv prej 22.000 trupash, ndër to 7000 oficerë e ushtarë vullnetarë shkodranë, kundrejt afro 55 000 trupash rrethuese serbo - malazeze, duke u shprehur: "Nuk do ta dorëzoj Shkodrën edhe sikur t'i vinte urdhër nga Stambolli". U vra si doli, nga shtëpia e Esad Pashës, më 30 janar 1913. U varros në Shkodër. Më 1993 është dekoruar "Për veprimtari patriotike të Klasisit Parë. (Përparim Rexhepi, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009, f. 2253 - '54).

MALET PUKË- MIRDITË NË MBROTJE TË SHKODRËS SË RRETHUAR NGA USHTRITË PUSHTUESE SERBO - MALAZEZE (1912 -1913)

Në një tjetër artikull po aq interesant, historiani Meçi përshkruan qëndresën e malësorëve të zonës Pukë - Mirditë në mbrojtje të Shkodrës së rrethuar nga ushtritë pushtuese serbo - malazeze para 111

(vijon ne faqen 13)

SUPLEMENTI LETRAT

Kontributi i studjuesit të mirënjohur Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Pukës në ndriçimin e historisë së një prej luftërave më heroike

"Na ka çue Shkodra ni fjalë"

(vijon nga faqja 12)

viteve.

Risi në këtë artikull është përjetësimi i heroizmit të shqiptarëve nëpërmjet këngëve popullore. Janë këngë që përjetësojnë qëndresën e 400 vullnetarëve të udhëhequr prej Mustafë agë Kryziut dhe Mehmet Dervishit, të cilët brenda fillimit të nëntorit 1912 u vendosën në pozicionet e Bërdicës, ku gjatë luftimeve me malazezët ranë dëshmorë të atdheut tre kabashës trim: Dem Ismail Ibrahim, Kurt Nezir Cina dhe Rexhë Adem Baci. "Me të ardhë porosia e Bajram Beg Currit, Zenel Mustafë Aga i Iballes me Mustafë agë Kryeziun dhe Salih agë Malziun (Vaspas) vendosën me kërkue 'një burrë për shpi me i shkue Shkodrës në ndihmë' para se të rrethohej nga ushtritë serbo-malazeze për t'u ndihmuar forcave shkodrane me pushkë për sy", shkruan Xh.Meçi. Ndërsa referuar të dhënave gojore, ai e njeh lexuesin me faktin se "Në çdo katund u vendos të merreshin masat për t'u vetëmbrojtur dhe të bëheshin përpjekje që me çeta të vogla ta sulmojnë ushtrinë pushtuese serbe, sapo të futej në Shtatë Bajraktë. (në krahinën) e Pukës, që nga Vaspasi e deri në Flet, Qafë-Mali, Fushë-Arrëz, Pukë e Kabash. Katundet e Rrugëmadhes: Flet-Xath, Kulumri, Sakat-Trun. 80 Shtëpi Thaç, lidhen besë me ia fillue pushkën që nga Fletit e mos me ia da deri sa të tërhiqet krejt. Po kështu si Vaspasi edhe Pistë-Gdheshtë. Në Lejthizë vendosën të sulmonin prapavinë e kësaj ushtrie, duke i shkaktuar sa më shumë humbje! Sepse kështu do të dobësoheshin edhe sulmet serbe të divizionit "DRINA" mbi mbrojtësit e Shkodrës. Por ky divizion goditjen e parë e mori në Vaspas nga çeta e Ismajl Arifit".

Në pjesën e parë të këtij libri, mbrojtja e Shkodrës kundër ushtrisë pushtuese serbo-malazeze jepet edhe nëpërmjet këngëve të rapsodit Prendush Gega, Artist i merituar.

Kështu autori sjell të freskëta për lexuesin vargjet: "Kur erdh serbi me Karadak, / Shkodra vogel u ba marak, / "Nuk e lshoi vendin pa gjak!, / nuk e lshon vendin pa u shkri!"... Dhe po aty, (fq.26) vargjet kuptimplota: "Top e pushkë digjet Shkodra! / Top e pushkë Shkodra shkret! / Për Shqipni po don me dek!"... Autori këtu sjell edhe referencën nga Miss Durham: "Malazezët të tërbuar nga që nuk po arrinin ta merrnin Shkodrën me forcën e armëve dhe nga dështimi i bisedimeve për dorëzim... deklarorin se do ta asgjësojnë gjithë popullsinë muslimane të Shkodrës!".

Ky libër ka vlera të veçanta se pikërisht në këtë 111 vjetor të asaj lufte heroike legjendare na njeh me qëndresën e shqiptarëve kundër pushtuesve barbarë serbo-malazes.

Libri i ri i studjuesit të mirënjohur Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Pukës "Na ka çue Shkodra ni fjalë"



SHQIPTARËT, NJË KOMB UNIK, SI KURRË NDOJËHERË NË HISTORINË TONË KOMBËTARE

Pjesë interesante e librit është edhe historia e Norës së e Mirditës (Marshterpa e Spaçit), për të cilën autori Xh. Meçi shkruan se "Ndërsa Nora legjendare e Kelmendit ishte e shek. XVII, NORA e Mirditës ishte rreth 150 vjetë më përpara, por e mbetur në heshtjen e harresës". Po ashtu në këtë libër mësojmë për qëndresën e Pukës dhe Malësisë së Gjakovës që shpëtojnë nga arrestimi i forcave osmane Hafiz Haxhi Ymer Prizrenin, kryetar i Komitetit Drejtues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1881).

Autori i këtij libri, Xhemal Meçi është i kudogjendur në përvjetorë të ngjarjeve e personaliteteve historike. Dhe jo vetëm fizikisht, por me shkrime mbresëlënëse. Të tillë janë në këtë libër artikujt: "Përurohet pllaka përkujtimore kushtuar atdhetarit Haxhi Rrustë Kabashi" (fq.41), ku më tej (fq.47) boton edhe fjalën e mbajtur nga gjeneral Rrahman Parllaku - Nderi i Kombit në këtë përkujtimore (me titullin sinjifikativ: Shqiptarët, një komb unik, si kurrë ndonjëherë në historinë tonë kombëtare").

Po në këtë linjë është edhe analiza e librit të poetit, prozatorit e kantautorit të njohur Naim Berisha "Të jetosh në paqe", ku sipas këndvështrimit të tij, hedh dritë mbi të vërtetën e origjinës të gjeneralëve të Skënderbeut Dhimitër e Nikollë Berisha.

Studjuesi i mirënjohur Xhemal Meçi (autor i librave të mëparshëm: "Puka që në lashtësi"; "Kanuni i Lekë Dukagjinit, variant i Pukës, Itali 1996"; "Ndue Jak Pjetri 'Mësues i Popullit'; "Migjeni në Pukë"; "Kanuni i Lekë Dukagjinit, variant i Mirditës, Tiranë 2001; "Kabashi"-monografi; "Poeti i Malësisë" dhe "Komani, trashëgimi iliro-arbërore") në këtë libër ("Na ka çue Shkodra ni fjalë") shkruan edhe për Zenel Xhemajl Kabashin, këtë burrë fisnik të Kabashit të Prizrenit, që sipas autorit ishte vetë historia dhe ndërgjëja kombëtare kosovare.

Në funksion të edukimit atdhetar të të rinjve tanë, Xh.Meçi bën pjesë të këtij libri edhe shkrimet me titujt: "Recitohen 'vaje'nga 'Lahuta e Malcis' e Fishtës në provim shteti (Instituti i Lartë Pedagogjik, Tiranë, Qershor 1968); "Piktori Abdurrahim Buza puthi në Pukë për herë të parë flamurin kombëtar shqiptar" (1922); "Legjenda dhe burime për shqiponjën e zezë dykrenare" (Prof. dr. Bardhosh Gaqe) etj.

KONKLUZIONE

Në këtë libër gjejmë pasqyrim veprimtari akademiko - shkencore, të zhvilluara në Shkodër, Pukë e Tiranë, me objekt studimin e historisë së rezistencës së shqiptarëve në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbo-malazeze (Nëntor 1912 - maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar, si dhe për traditat, kulturën e lashtësinë e gjuhës shqipe.

Nëpërmjet hulumtimit të studimeve skurpuloze, autori i këtij libri sjell për lexuesin shkrimet interesante: "Puka - një qytet i bukur turistik malor" (ballë madhështisë së Alpeve Shqiptare), në 110-vjetorin e hapjes së shkollës Shqipe të Kabashit (1914-2024); "Abacia e Shën Palit të Pukës, Grykë Kabash në 1440 - vjetorin e saj" (për të cilën i referohet prof. Injac Zamputi, historian dhe përkthyesi i relacioneve të shek. XVI-XVII, që e radhit krahas abacive ma të njohuna në Shqipni). Po ashtu Xh.Meçi shkruan për personalitetin e shquar islam dhe të kulturës kombëtare Hafiz Haxhi Hysen Ismail Muçaj - një erudit në traditën e dijes dhe të kulturës sonë gjuhësore mbarëkombëtare shqiptare. Ndërsa në 50 - vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 20-25 NËNTOR 1972), trajton referencën e Ndre Mjedës "Kjoft mallkue kush qet ngatrrime ndër kto vllazen shoq me shoq, kush i dan me fjalë e shkrime, çka natyra vet përpoq!"..., për të vijuar me tej me shtjellimin e referatit të Profesor E. Çabej në Kabash të Pukës për sesionin e parë shkencor për toponimet, Kabash Qendër, 21 maj 1977, si dhe me profilin e Prof. David Luka i cili ndërroi jetë duke lënë pas kujtimin e një studiuesi të përmasave akademike, vazhdues i denjë i akademikut E. Çabej për gjuhësinë shqiptare, autor i botimit të 20 vëllimeve "Studime Gjuhësore".

Në librin "Na ka çue Shkodra ni fjalë", autori Xhemal Meçi shkruan edhe për veprimtarinë kërkimore - shkencore të Jeronim De Radës në fushën e studimeve filologjike dhe në lëmin e gjurmimeve onomastike e në atë të toponimisë historike (referuar kumtesës së Prof. dr. Jup Kastrioti, botuar në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes së tij (1924-2024)..., shkruan për kontributin e Prof. dr. Eqrem Zenelaj, "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" në fushën e studimeve dhe botimeve për pasqyrimin e historisë së popullit shqiptar dhe prejadhjes sonë iliro-pellazge... Në kënvështrimin tim analitik të kësaj veprë, interes për lexuesin paraqesin edhe artitujt: "Iballa sipas albanologut të shquar Han" ((JOHANN GEORG: von HANN, albanolog i shquar, 1811-1869) në botimin "Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit", 1863; "Migjeni në Pukë", si dhe studimi i gjuhëtarit të njohur Petro Zheji: "Shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve", studim ky që u vlerësua nga Kadare, por u injorua nga Akademia e Shkencave.

Në tërësinë e tij libri "Na ka çue Shkodra ni fjalë" bart vlera të rëndësishme studimore për faktin se në të gjejmë prurjet më të reja në fushën e studimeve për historinë kombëtare shqiptare. Në faqet e tij ka studime dhe artikuj që përbëjnë arritjet më të reja të historiografisë shqiptare për ngjarjet dhe figurat historike.

SPECIALE

Promovohet romani “Shtëpia e verdhë”, vepra më e re e shkrimtarit dhe dramaturgut të njohur Bashkim Hoxha

“Shtëpia e Verdhë” botim i prestigjiozes “ONUFRI” nuk është thjesht një roman, por një ftesë për të reflektuar mbi të shkuarën dhe për të kërkuar të vërtetën përmes një lenteje artistike

Romani “Shtëpia e verdhë”, botimi më i fundit i prozatorit dhe dramaturgut të mirënjohur Bashkim Hoxhëa, mbrëmjen e së mërkurës të 14 gushtit 2024 u prezantua mes një rrethi miqsh, shkrimtarësh, personalitetesh të artit dhe kulturës, por edhe shumë qytetarëve durrsakë dhe turistëve.

Në një fshat të thellë të Matit, Shtëpia e Verdhë mbetet një mister që kuriozon gjithkënd dhe pas dy dekadash. E përfolur si skenë e historive të errëta dhe të pabesueshme, ajo rikthehet në vëmendje përmes romanit më të ri, të shkrimtarit dhe dramaturgut të suksesshëm Bashkim Hoxha.

Lexues dhe dashamirës të shumtë nga Shqipëria dhe Kosova u mblodhën buzë detit për të diskutuar mbi këtë vepër që shënon një tjetër arritje në karrierën e këtij autori. Ajo sjell në vëmendje një tematikë që ka dashur të hedhë baltë mbi UÇK-në dhe drejtuesit e saj me akuzat për trafik organesh dhe varre masive, të përmendura në raportin e Dick Martit.

“Shtëpia e Verdhë” botim i prestigjiozes “ONUFRI” nuk është thjesht një roman, por një ftesë për të reflektuar mbi të shkuarën dhe për të kërkuar të vërtetën përmes një lenteje artistike.

Lufta çlirimtare e popullit të Kosovës, por dhe makinacionet e mëtejshme për ta bërë pis fitoren e UÇK-së, prej vitesh e trazonin ndërgjegjen e autorit Bashkim Hoxha, por edhe atë të gazetarit profesionist. Nëpërmjet këtij romani, ai përcjell tek lexuesi mesazhin se “Shtëpia e Verdhë” është një problem bashkëkohor sot, ai i fake news (lajmeve të rreme) dhe ai i deformimit të realiteteve dhe i përdorimit të propagandës si mjet lufte.

“Nga historia e ‘Shtëpia e verdhë’, unë kam marrë vetëm të vërtetën e akuzave të rreme që janë bërë. Kjo është pjesa e realitetit në roman, ndërsa personazhet i kam trilluar, janë personazhe letrare që mbarin mesazhe të gjithanshme, -thotë shkrimtari B.Hoxha.

Ndoshta për vet temën që trajton



romani, që lidhet me çështjen aq shumë të përfolur ndërkombëtarshit të gjoja trafikimit të organeve nga UÇK-ja por ndoshta edhe për një ringjallje të ndjesisë së mirë për librin, në festën e promovimit u bashkuan shumë njerëz. Jo vetëm si lexues e spektatorë, por si organizatorë të kësaj feste duke i dhënë asaj një përmasë të madhe. Bashkia e qytetit kishte vënë në dispozicion teknikën dhe infrastrukturën e duhur për këtë eveniment. Shoqata “Durrësi Autok-

ton”, përveç pranisë së intelektualëve të shquar të qytetit, e ka konsideru-

ar sheshin Marinari edhe si një takim kulturor me durrsakët e emigruar që, si zakonisht, në gusht vijnë pranë familjeve plot mall. Ish themelues të UÇK-së, që me përjetimet dhe botimet e tyre e kanë ndihmuar mjaft autorin për këtë libër për të qënë pranë të vërtetës së ngjarjes, u bënë thirrje në rrjetet sociale të gjithë atyre kosovarëve që ndodheshin në Durrës që në datën e caktuar të bëheshin pjesë e kësaj ngjarjeje, jo vetëm letrare

Mbrëmja letrare u shoqërua dhe me ekspozimin e mjaft fotove dëshmi, të pasojave të luftës në Kosovë, si dhe punimet në pikturë e skulpturë të tre artistëve nga Mitrovica.

Arti dhe historia u ndërthurën në këtë mbrëmje vere për të ofruar një perspektivë të re dhe shuar zërat mbi skenarin e errët të shtëpisë që ende tërheq vëmendjen.

Kryetari i shoqates "Durrësi Autokton" ing. Abdulla Deliallisi nderoi me titullin "Mirënjohja e Qytetit të Durrësit" z. Bujar Hudhri, botuesin e Shtëpia Botuese Onufri me motivacionin: për kontributet e ONUFRI në botimin dhe promovimin e letërsisë shqipe.

Aktiviteti u shoqërua me ekspozita fotografike dhe pikturë nga artistët fotografi Gëzim Domi dhe piktorët nga Mitrovica Tafil Peci Boletini, Gani Sadiku, Shyqri Çeliku. Tabllaja e shëtitores u plotësua me krijimet e të rinjve të qendrës Durrësi Aktiv,

Interpretimet e studios së baletit Arian Plaku dhe të artisteve të mrekullueshem Olta Juba, Violeta Beshiri, Alesio Hysenaj i dhanë ngjyra feste manifestimit letrar, festë që u realizua më së miri me përkujdesje nga Bashkia Durres.

Lufta çlirimtare e popullit të Kosovës, por dhe makinacionet e mëtejshme për ta bërë pis fitoren e UÇK-së, prej vitesh e trazonin ndërgjegjen e autorit Bashkim Hoxha, por edhe atë të gazetarit profesionist. Nëpërmjet këtij romani, ai përcjell tek lexuesi mesazhin se “Shtëpia e Verdhë” është një problem bashkëkohor sot, ai i fake news (lajmeve të rreme) dhe ai i deformimit të realiteteve dhe i përdorimit të propagandës si mjet lufte

